AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave "Menaxhim Bankar"**

**Universiteti Privat "Albanian University"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Profesor i Asociuar Genc Alimehmeti

Dr. Andromahi Kufo

Maj/2021

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Për Programin e studimit: Master i Shkencave në Menaxhim Bankar**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Privat "Albanian University" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Shkencave Ekonomike, [Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike] |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 56, datë 21.01.2009<br>Urdhër UMASH nr 308, datë 08.06.2010 për lejimin e veprimtarisë akademike |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës: | UMASh Nr. 385, datë 06.09.2013 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | Akreditimi periodik: VBA Nr. 81, datë 27.10.2018 [vlefshmëria e akreditimit: 30.09.2020; kohëzgjatja 2 vite akademike]<br>[me rekomandime] |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli II |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total [ECTS]: | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha [shqip/tjetër]: | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | JO |
| 13.1 | Diplomë e përbashkët [shëno emërtimin]: | - |
| 13.2 | Diplomë e dyfishtë [shëno emërtimin]: | - |
| 14 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 15 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | **6 PAE** (2 pof.As, 4 Dr) dhe **2 PAK** (2 Prof.As) |
| 16 | Numri i studentëve: | 37 |
| 17 | Komente / të tjera: | |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti privat “Albanian University”, Tiranë ka filluar aktivitetin si institucion privat i arsimit të lartë bazuar në VKM Nr. 197, datë 10.04.2004 “*Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “UFO Dental*”. Më pas ka ndryshuar status dhe është riorganizuar me VKM nr.597, datë 28.5.2009 “Për ndryshimin e emrit të Universitetit Privat “UFO University” dhe me VKM nr. 603, datë 24.8.2011 ka kryer ndryshimin e emrit të universitetit privat nga "UFO University" në "Albanian University". Institucioni eshte riorganizuar me Urdhër MAS Nr.52, datë 05.02.2016.

Akreditimi institucional është kryer me Vendim i BA Nr. 90, datë 20.10.2017 “*Për akreditimin e pare të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Privat “Albanian University*”.

Ndërsa akreditimi periodik është kryer me Vendim i BA Nr. 01, datë 24.01.2020 "Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat “Albanian University”, me kohëzgjatje prej 3 [tre] vite.

Sipas Statutit dhe Rregullores aktualisht Albanian University është i organizuar në 3 Fakultete dhe 10 Departamente.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar”, i licensuar me VKM nr. 56, datë 21.01.2009, ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Departamenti i Shkencave Ekonomike.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në të cilën bën pjesë edhe programi nën procesin e vlerësimit përbëhet nga 3 Departamente si më poshtë:

1. Departamenti i Arkitekturës
2. Departamenti i Shkencave Ekonomike
3. Departamenti i Inxhinierive

Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar” është akredituar së fundmi me Vendim nr.81 date 27/10/2018, me kohëzgjatje 2 vjet dhe që perfundon më 30/09/2020, me kërkesë për plotësim të rekomandimeve të dhëna nga grupi i ekspertëve të mëparshëm.

Raporti i Vlerësimit nga Ekspertët e Jashtëm, shqyrton ecurinë e programit përgjatë 3 viteve akademike 2018 – 2019, 2019-2020 dhe 2020-2021 si dhe plotësimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm. Ky raport përshkruan analizën mbi treguesit e matshëm, si dhe shkallën e përmbushjes së standarteve sipas kërkesave të cilësisë së ASCAL dhe nëse programi është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të Albanian University.

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

**Rekomandimet**

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 81, datë 27.10.2018, për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Menaxhim bankar" të Universitetit Privat "Albanian University", janë si vijon:

1. *Institucioni, përpara fillimit të vitit akademik 2019-2020, të rishikojë kurrikulën dhe syllabuset e programit të studimit, me qëllim orientimin e tyre më së shumti drejt cështjeve që lidhen me financën dhe bankën, për të qenë në përputhje me emërtimin dhe qëllimet e formimit të këtij programi studimi.*

Në përmbushje të këtij rekomandimi institucioni ka kryer procedurën e rishikimit të kurrikulës dhe përcaktimin e lëndëve të cilat përputhen me emërtimin dhe qëllimin e programit. Institucioni ka kryer rishikimin e kurrikules ku ka ndryshuar lendet e meposhtme per t'i perputhur ato me emertimin dhe qellimet e programit:

1. Lenda "Menaxhim Risku i Avancuar" eshte ndryshuar emertimi ne "Menaxhim Risku Bankar" dhe permiresuar sillabusi.
2. Lenda "Ekonometri" eshte ndryshuar emertimi ne "Ekonometri ne Finance" dhe permiresuar sillabusi.
3. Lenda "Sjellja Organizative dhe Etika e Biznesit" eshte ndryshuar emertimi "Etika e Biznesit Bankar" dhe ndryshuar sillabusi sipas specifikave te sektorit bankar.
4. Lenda "Menaxhimi Strategjik" eshte zevendesuar me "Marketing Bankar" sipas kurrikulave te programeve te ngjashme te ofruara nga universitete te tjera.
5. Lenda "Kontabilitet i Avancuar" eshte ristrukturar ne "Kontabilitet dhe Teknika Bankare" dhe ndryshuar syllabusi sipas specifikave te sektorit bankar.
6. Lenda "E Drejta Financiare" eshte zevendesuar me "E Drejta BAnkare" dhe ndryshuar syllabusi sipas specifikave te sektorit bankar.
7. Lenda "Menaxhimi Fiskal" është bërë lëndë me zgjedhje dhe lënda "Menaxhimi i Sigurimeve" është bërë e detyrueshme.

Të gjitha ndryshimet janë nen 20% të totalit te krediteve te programit. Procesi I rishikimit ka ndjekur hapat ligjore dhe institucionale dhe eshte aplikuar në vitin akademik 2020-2021. GVJ konsideron se permiresimet ne kurrikul janë te mjaftueshme per te konsideruar te plotesuar rekomandimin e pare dhe jane ne perputhje me objektivat specifike te programit, referuar ne standartit I.3, kriteri 1.

**Ky rekomandim është plotësuar.**

2. *Institucioni, të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës së stafit akademik duke përputhur fushën e ekspertizës dhe kualifikimit të tij me lëndët që mbulojnë, duke parashikuar dhe mundësinë e rekrutimit të stafit të ri me kualifikim të posacëm në fushën e ngushtë të programit.*

Në përmbushje të këtij rekomandimi dhe duke ju referuar standartit II.5, kriteri 2, AU:

a) Ka rishikuar ngarkesën e stafit akademik dhe ka përputhur fushën e ekspertizës dhe kualifikimit më lëndët përkatëse.

b) Stafi akademik i ka kredencialet dhe ekspertizën në ofrimin e lëndëve specifike të programit.

c) Ka proceduar në publikime per rekrutime stafi sipas dokumentacionit te vene ne dispozicion, duke përmbushur kërkesat ligjore ne lidhje me 70%; por keto rekrutime nuk kanë qenë të mjaftueshme për të rritur në përgjithesi numrin e stafit akademik në total. Numri i stafit akademik realisht ka pësuar ulje përgjatë periudhës në rishikim.

Nga statistikat e ngarkeses se stafit akademik ngarkesa vijon të jetë e lartë, vecanërisht për vitin 2019-2020, duke arritur që një pedagog të mbuloje deri në 10 module gjatë një viti akademik. Përpjekjet e institucionit janë padyshim afektuar edhe prej pandemisë, por mendojmë se për të plotësuar këtë rekomandim nevojitet përpjekje me e madhe nga institucioni.

**Ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.**

3. *Institucioni, të përmirësojë nga ana sasiore dhe cilësore literaturën e vënë në dispozicion të studentëve, duke e përshtatur atë dhe me nivelin e këtij programi studimi.*

Në lidhje me këtë rekomandim është kryer:

a) Një rishikim i syllabuseve nga pedagogët, në mënyrë periodike, duke përfshirë literaturë vendase dhe të huaj për të përmbushur objektivat e programit.

b) Nje kerkese nga Fakulteti i Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike për porositjen e 17 teksteve të huaja në bibliotekën e institucionit të cilat do të shërbejnë edhe për programin ne vlerësim.

Ky rekomandim duhet te jete nje proces ne vazhdimesi i institucionit për të përmiresuar cilësine e programit dhe për të mbështetur studentet.

**Ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.**

4. *Institucioni, të shtojë numrin e laboratorëve dhe kapaciteteve kompjuterike në dispozicion të studentëve.*

Në lidhje me këtë rekomandim institucioni ka vënë në dispozicion laboratorin kompjuterik të informatikës, ku disponohen 25 vende pune dhe janë pajisur me softe të nevojshme për programin respektiv. Institucioni nuk ka shtuar numrin e laboratoreve dhe kapaciteteve kompjuterike.

**Ky rekomandim është plotësuar.**

5. *Institucioni, të mbështesë më tepër studentët dhe stafin akademik, për përfshirjen e tyre në kërkim dhe aktivitete shkencore, trajnime si dhe vendosjen e një sistemi pikëzimi dhe bonusesh, për stafin akademik.*

Në përmbushje të këtij rekomandimi dhe duke ju referuar standartit I.6 dhe kritereve të analizuara në raport, AU ka ndërmarrë disa masa si:

a) Organizmi i konferencës vjetore shkencore të Universitetit me pjesëmarrje nga akademikë dhe studentë në bashkëpunim me IAL të tjera,

b) Pjesëmarrja në kongresin studentor te AMF, duke i mbështetur dhe inkurajuar studentët,

c) Mbështetja financiare e pedagogëve për botimet e tyre që përfshijnë rezultatet e punimeve të tyre shkencore [kjo është konfirmuar edhe nga ana e stafit akademik]

d) Botimi i revistës Optime me punime shkencore nga akdemikë

e) Krijimi i një plani akademik në lidhje me kërkimin shkencor, trajnimet dhe aktivitetet ekstrakurikulare dhe vlerësimi i arritjeve të ketij plani në raportin vjetor të Departamentit.

**Nevojitet gjithsesi plotësimi i rekomandimit** përsa i përket sistemit të pikëzimit dhe bonuseve për kërkimin shkencor, si dhe përfshirje të aktorëve ndërkombetarë në konferencën vjetore. Më shumë përpjekje e organizuar përsa i përket punimeve të studentëve, si psh një konferencë që përfshin vetëm punimet e tyre.

**Ky rekomandim është plotësuar kryesisht.**

6. *Institucioni, të përditësojë bibliotekën me literaturë cilësore të viteve të fundit, përkthime të bëra nga universitete të tjera të teksteve bazë në këtë fushë, me botime akademike periodike apo periodikë ndërkombëtarë.*

Në përmbushje të këtij rekomandimi GVJ konstatoi se Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është vënë në dispozicion të studentëve me 246 tituj librash në fushat ekonomike. Në bibliotekë gjendet mbi 80% e literaturës në gjuhën shqipe, e detyruar në syllabuset e lëndëve. Këto libra gjenden në kopje të mjaftueshme dhe në edicionet e tyre më të fundiLiteratura e ofruar si në formë hardcopy, në format elektronik dhe online mundësojnë realizimin me sukses të projekteve kërkimore-shkencore të moduleve e veprimtarive mësimore të kërkuara nga pedagogët në kuadër të mësimdhënies dhe në përgatitjen e tezës së diplomës.

Konstatohet se AU ka vënë dispozicion të studentëve një sërë librarish online të cilat janë të aksesueshme nën kujdesin e punonjëses së bibliotekës në qendrën e internetit **[RVB Tabela 17].** Gjithashtu, u evidentua që biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të cilat u vijnë në ndihmë studentëve për të aksesuar në bibliotekat online që AU disponon. Konstatohet se AU çdo vit planifikon fond të veçantë për blerjen e literaturës së detyrueshme për çdo program studimi dhe në mbështetje të kërkimit shkencor. Çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimet e syllabuseve, departamenti bën kërkesat e tij për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër **[Aneksi R.3 - Kërkesë për pasurimin e bibliotekës 2020-2021].**

**Ky rekomandim është plotësuar kryesisht.**

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në VKM nr. 109 për organizmin e ASCAL, dhe në "*Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017*", ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga instucioni për akreditimin periodik të programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" (më tej MSHMB). Grupi i jashtëm i vlerësimit përbëhet si më poshtë:

Prof.Asoc. Genc ALIMEHMETI, Universiteti i Tiranës

Dr. Andromahi KUFO, Universiteti New York Tirana

Grupi i ekspertëve të jashtëm është asistuar nga koordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Pas komunikimit nga ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ekspertët studiuan dhe vlerësuan dosjen e programit, raportin e vetevlerësimit dhe gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, ngarkuar në sistem. Ekspertët mbas njohjes dhe vlerësimit të gjithë dokumentacionit, bënë përgatitjet e nevojshme, përpiluan pyetjet apo evidentuan paqartësitë e tyre, dhe u përcaktuan npërmjet ASCAL-it datat e vizitave në institucion. Vizita në institucion u realizua në datën 22 Janar 2021, (një ditë) për shkak të situatës së shkaktuar nga Pandemia e Covid-19. I gjithë stafi akademik dhe administrativ i Albanian University u angazhua për t'iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm të vlerësimit.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master i Shkencave "Menaxhim Bankar".

Në fund paraqiten një analizë përmbledhëse mbi programin e studimit që akreditohet si dhe rekomandimet për përmirësim. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 04.03.2021, përmes sistemit AMS, dhe me shkresë zyrtare Nr. 11/14 Prot., datë 27.04.2021, Universiteti Privat "Albanian University" është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm. Me datë 05.05.2021, AU përcjell nëpërmjet AMS dhe me shkresë Nr. 220/1 Prot., datë 05.05.2021 disa komente në lidhje me Draft RVJ.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Universitetit Privat AU, sqaron si më poshtë:

**Rekomandimi 2 (VBA Nr. 81, datë 27.10.2018), fq. 4**: "Institucioni, të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës së stafit akademik duke përputhur fushën e ekspertizës dhe kualifikimit të tij me lëndët që mbulojnë, duke parashikuar dhe mundësinë e rekrutimit të stafit të ri me kualifikim të posacëm në fushën e ngushtë të programit.

Në përmbushje të këtij rekomandimi dhe duke ju referuar standardit II.5, kriteri 2, AU: a) Ka rishikuar ngarkesën e stafit akademik dhe ka përputhur fushën e ekspertizës dhe kualifikimit më lëndët përkatëse. b) Stafi akademik i ka kredencialet dhe ekspertizën në ofrimin e lëndëve specifike të programit. c) Ka proceduar në publikime për rekrutime stafi sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke përmbushur kërkesat ligjore në lidhje me 70%; por këto rekrutime nuk kanë qenë të mjaftueshme për të rritur në përgjithësi numrin e stafit akademik në total. Numri i stafit akademik realisht ka pësuar ulje përgjatë periudhës në rishikim. Nga statistikat e ngarkesës së stafit akademik ngarkesa vijon të jetë e lartë, vecanërisht për vitin 2019-2020, duke arritur që një pedagog të mbuloje deri në 10 module gjatë një viti akademik. Përpjekjet e institucionit janë padyshim afektuar edhe prej pandemisë, por mendojmë se për të plotësuar këtë rekomandim nevojitet përpjekje me e madhe nga institucioni."

**Komenti i AU:** Sqarojmë që në kriterin 2, Standardi II. 5, ekspertët komentojnë "70% e personelit akademik që jep mësim në këtë PS është PAE, të gjithë pjesëtarë në Departamentin e Shkencave Ekonomike, të cilët mbulojnë ngarkesën më të madhe në këtë PS. Të tjerët janë PAE nga IAL të tjera. Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrale që mban një pedagog për këtë program është 1 lëndë, me një numër maksimal lëndësh semestrale 2 per programin përkatës. Ndërsa ngarkesa totale vjetore për një pedagog varion nga një lëndë në vit, në 10 lëndë në vit (referuar vitit të plotë akademik 2019-2020). Kriteri në lidhje me ngarkesën mësimore dhe numrin e lëndëve/ moduleve që mund të mbulojë një pedagog nuk plotësohet. GVJ konstatoi që i gjithë personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie në këtë PS ka nivelin e kërkuar të kualifikimit dhe angazhim maksimal për zbatimin e PS."

Meqenëse angazhimi i Departamentit dhe Institucionit për përmbushjen e rekomandimit, sipas kritereve ligjore dhe specifikave të cituara dhe pranuara më lart, është maksimal, Ju lutemi të rishikoni vlerësimin pjesërisht për këtë rekomandim, duke mbajtur në vëmendje përmbushjen në tërësi të tij, dhe jo identifikimin (përgjithësimin) e të gjithë stafit akademik që jep mësim në këtë program (10 pedagogë me tituj akademik Dr. e sipër) me një rast (pedagogia Dr. Besjana Mema e profilit Matematikë & Informatikë që në DSHE mbulon vetëm 2 lëndë specifike të një fushe të gjerë).

**Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ **nuk e pranon** komentin e IAL dhe Raporti **nuk ndryshon**. Në bazë të argumentit të dhënë edhe nga vetë institucioni GVJ ka percaktuar se ky rekomandim eshte plotesuar kryesisht, po ashtu jane permendur te gjitha veprimet e institucionit dhe eshte identifikuar dhe justifikuar edhe se c'fare nuk eshte implementuar.

**Rekomandimi 3, fq. 5:** "Në lidhje me këtë rekomandim është kryer: a) Një rishikim i syllabuseve nga pedagogët, në mënyrë periodike, duke përfshirë literaturë vendase dhe të huaj për të përmbushur objektivat e programit. b) Nje kerkese nga Fakulteti i Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike për porositjen e 17 teksteve të huaja në bibliotekën e institucionit të cilat do të shërbejnë edhe për programin ne vlerësim. Ky rekomandim duhet te jete nje proces ne vazhdimesi i institucionit për të përmiresuar cilësine e programit dhe për të mbështetur studentet."

**Komenti i AU:** Rishikimi i literaturës dhe blerjet e teksteve të reja sic evidentohet edhe nga GVJ janë një proces i vazhdueshëm. Sa më sipër, sugjerojmë GVJ të vlerësojë angazhimin në këtë drejtim të AU, duke ALBANIAN UNIVERSITY UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME marrë në konsideratë dhe kohën e shkurtër nga akreditimi i fundit (tetor 2018). Ju lutemi të rishikoni vlerësimin pjesërisht të këtij rekomandimi, sepse DSHE ka blerë tituj ekonomikë (tekste) – 44 vitin 2019 dhe 17 vitin 2020 dhe do të vazhdojë të përmirësojë bibliotekën me tituj cdo vit akademik. Një nga përmirësimet e përvitshme që i bëhen syllabusit të lëndëve brenda masës së lejuar është pikërisht përditësimi i literaturës dhe DSHE e merr seriozisht këtë çështje cdo fillim viti akademik. Ky mbetet një proces në përmirësim të vazhdueshëm që nuk mund të ketë një standard përmbyllës.

**Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ **nuk e pranon** komentin e IAL dhe Raporti **nuk ndryshon**. Në bazë të argumentit të dhënë edhe nga vetë institucioni, Rekomandimi 3 nuk ka lidhje vetem me titujt e bibliotekes por edhe me rishikimin e literatures.

**Rekomandimi 6, fq. 6:** "Institucioni, të përditësojë bibliotekën me literaturë cilësore të viteve të fundit, përkthime të bëra nga universitete të tjera të teksteve bazë në këtë fushë, me botime akademike periodike apo periodikë ndërkombëtarë." Në përmbushje të këtij rekomandimi GVJ konstatoi se…"

> **Komenti i AU:** AU vlerëson konstatimet pozitive të GVJ mbi përmbushjen e këtij rekomandimi. Për sa konstatohet në fq.6 të Draft Raportit, përderisa nuk ka mungesa në plotësimin e rekomandimit, mendojmë që rekomandimiështë i përmbushur plotësisht, dhe jo kryesisht.

**Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ **nuk e pranon** komentin e IAL dhe Raporti **nuk ndryshon**. Në bazë të argumentit të dhënë edhe nga vetë institucioni, rekomandimi 6 lidhet me rekomandimin 3 dhe me viziten ne biblioteken e institucionit. Nuk mund te vleresohet plotesisht.

**Konstatime:** Standardi I.3, fq. 10, është vlerësuar me shkallën e përmbushjes kryesisht ndërkohë që komentet në të gjitha kriteret e standardit janë pozitive dhe vlerësojnë punën e bërë për përmbushjen e këtij Standardi. Për sa më sipër, Standardi I.3 konsiderohet i përmbushur plotësisht.

Standarti II. 5, fq.29: "Kriteri në lidhje me ngarkesën mësimore dhe numrin e lëndëve/moduleve që mund të mbulojë një pedagog nuk plotësohet."

> **Komenti i AU:** Në lidhje me ngarkesën, Ju lutem referojuni përgjigjes për Rekomandimin 2, cituar më lart.

**Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ **nuk e pranon** komentin e IAL dhe Raporti **nuk ndryshon**. Në bazë të argumentit të dhënë edhe nga vetë institucioni ky rekomandim nga konstatimet dhe komentet me siper nuk mund te vleresohet i plotesisht.

**Konstatime:** Standardi II.6 është vlerësuar me shkallën e përmbushjes kryesisht ndërkohë që komentet në të gjitha kriteret e standardit janë pozitive dhe vlerësojnë punën e bërë për përmbushjen e këtij Standardi. Për sa më sipër të rishikohet përmbushja e Standardi II.5 dhe II. 6 plotësisht.

**Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ **nuk e pranon** komentin e IAL dhe Raporti **nuk ndryshon**. Në bazë të argumentit të dhënë edhe nga vetë institucioni Standarti II.5 nuk mund te vleresohet plotesisht, pasi kriteri 2 nuk plotesohet. Standarti II.6 nuk mund te vleresohet kryesisht, pasi kriteri 3 dhe 4 nuk plotesohen.

**Konstatime:** Standardi IV.4 është vlerësuar me shkallën e përmbushjes kryesisht ndërkohë që komentet në të gjitha kriteret e standardit janë pozitive dhe vlerësojnë punën e bërë për përmbushjen e këtij Standardi. Për sa më sipër Standardi IV.4 konsiderohet i përmbushur plotësisht.

**Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ **nuk e pranon** komentin e IAL dhe Raporti **nuk ndryshon**. Standarti IV.4 lidhet me rekomandimin 3 dhe 6 dhe nuk mund te vleresohet plotesisht.

**Standardi V.1, fq.54:** "Por në Rregulloren e Masterit të Shkencave në Menaxhim Bankar [Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar", Kreu 3, neni 10, fq.8-9] janë këto pika por mungon:

përcaktimi mbi gjuhën e huaj [sipas MASR] dhe letra e interesit [edhe pse kjo e fundit nuk është domosodshmëri].”

> **Komenti i AU:** Në Rregulloren e programit Msc. në “Menaxhim Bankar” kërkesa për kriterin e gjuhës së huaj gjendet tek Neni 10, Pika 8, “Paraqitja e një dokumenti që vërteton aftësitë e njohjes së njërës prej 5 gjuhëve europiane me anë të një prej testeve ndërkombëtarisht të njohura nga MASR”.

**Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ **e pranon** komentin e IAL dhe Raporti **ndryshon**. Në bazë të argumentit të dhënë nga institucioni, sugjerojmë që kriteri i gjuhës së huaj të specifikohet si kriter për pranimin në Masterin e Shkencave në Menaxhim Bankar dhe jo vetëm si dokument për aplikim.

**Standardi V.1, fq.55:** “Në RVB shënohet se në programet e ciklit të dytë mund të regjistrohen edhe student të huaj, në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, por në atë nen nuk specifikohet mundësia e regjistrimit për student të huaj.”

> **Komenti i AU:** Sa më sipër referohuni dokumentacionit të aplikimit për pranim në këtë program, cituar po në fq.55 të Draft-RVJ “7. Shtetasit e huaj duhet të paraqesin edhe lejën e qëndrimit në Shqipëri [kopje e noterizuar]”
>
> Standardi V.1 është vlerësuar me shkallën e përmbushjes kryesisht dhe nëse gjetja e mësipërme ka ndikuar vlerësimin, Ju lutemi të rishikohet.

**Përgjigje e GVJ:**

Në përfundim GVJ e pranon komentin e IAL dhe Raporti ndryshon. Në bazë të argumentit të dhënë nga institucioni sugjerojmë që fakti se shtetasit e huaj duhet të paraqesin edhe lejën e qëndrimit në Shqipëri nënkupton se shtetasit e huaj mund të pranohen për të aplikuar në Masterin e Shkencave në Menaxhim Bankar por duhet specifikuar dhe duhet cilësuar që kriteret të mëtejshme mund të vendosen nga MASR me udhëzimet përkatëse.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar"**

# I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/MASTER I ARTEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Programi i studimit [PS] ka si objektiv ofrimin e njohurive të thelluara praktike dhe teorike dhe avancimin e kërkimit shkencor për studentët të cilët duan të vazhdojnë studimet e ciklit të tretë në deget Financë, Bankë, Menaxhim, Kontabilitet, Menaxhim Korporatash, Menaxhim Institucionesh Finaciare etj. Ky objektiv është në përputhje me misionin, strategjinë dhe qëllimin e AU sic përcaktohen në planin strategjik institucional. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në AU konkludon që PS i ofruar nga AU mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 4]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | AU e mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në traditat më të mira kulturore, arsimore dhe shkencore të vendit. Ky është një parim i sanksionuar në planin strategjik institucional, ne rregulloren mësimore to PS dhe i konfirmuar gjatë vizitës në institucion në takimin me drejtuesit e njësisë kryesore dhe të njësisë bazë.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 4]** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | AU ka në misionin e tij ofrimin e programeve të studimit në fusha të ndryshme në të tri ciklet e studimit, si dhe programe studimi me karakter profesional dhe shkencor. Qëllimi i institucionit është nxitja e njohurive dhe shkencës përmes veprimtarisë akademike, punës kërkimore shkencore, aktivitetit krijues dhe bashkëpunimit më të tretët.<br><br>GVJ, mbështetur në Anekset e AU si Plani Strategjik 2017-2022, rregullorja e PS konstaton se PS "Master i Shkencave në Menaxhim Bankar" përputhet me fushën e veprimtarisë së institucionit, qëllimet dhe misionin e tij.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 4]** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | AU ka vënë theksin dhe në dimensionin social të institucionit në Planin e tij Strategjik. AU ndër të tjera synon të ndihmojë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal, të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore. Ky dimension është mbajtur parasysh në hartimin e këtij PS, i cili |

| | |
|---|---|
| | është ideuar që të përmbushë kërkesat e grupeve të interesit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 4, objektivat specifike]** |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor | Një prej objektivave kryesorë të programit të studimit sipas rregullores së tij është krijimi i njohurive të thelluara teorike për të vazhduar me ciklin e tretë të studimeve. Përmbushja e këtij objektivi kryhet përmes aftësimit të studentëve në kërkimin shkencor.<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 4, objektivat specifike]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional si plani strategjik institucional 2017-2022 dhe dokumentacioni në nivelin e njësisë bazë si rregulloret e Fakultetit dhe Departamentit, e vecanërisht rregullorja mësimore e PS konstatohet se ky program është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit. Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të AU, rregulloren e tij dhe të gjitha aktet e nxjerra për zbatimin e tij.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; 1.4 Rregullore Albanian University.pdf; 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 4]** |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Në planin strategjik institucional 2017-2022 të AU përcaktohen drejtimet prioritare akademike të cilat përfshijnë edhe fushën e ekonomisë ndër të tjerave si shkencave humane, mjekësia, farmaceutika etj.<br><br>Në rregulloren e AU përshkruhen Njësitë që ofrojnë këto programe si dhe rregullat e komunikimit e të organizimit të institucionit. Njësitë kryesore ofrojnë programe studimi të cikleve të ndryshme dhe fushat specifike të secilës dhe përcaktohen në rregulloren e universitetit.<br><br>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe gjatë takimit me drejtuesit e Njësisë bazë dhe Njësisë kryesore vlerëson se programi i studimit është ofruar dhe |

| | |
|---|---|
| | zbatohet duke u mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; 1.4 Rregullore Albanian University.pdf; 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf]** |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Përmbajtja, struktura dhe organizimi i PS është hartuar në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për programet e studimit të ciklit të parë. Dokumentat e PS si Plani mësimor i programit dhe Rregullorja e PS japin të dhëna të plota mbi strukturën dhe përmbajtjen e PS. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave GVJ konstaton se PS është organizuar në përputhje me drejtimet akademike të institucionit.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; 1.4 Rregullore Albanian University.pdf; 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf]** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | Duke ju referuar planit strategjik dhe rregullores së programit të studimit GVJ konstaton se PS hartohet e zhvillohet sipas strategjive kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe zhvillimeve të fundit të tregjeve globale për t'i përqasur studentët edhe më tepër me tregun.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf, fq. 3; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf]** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br>**Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e | Qëllimet dhe objektivat e PS janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit, neni 4 dhe të ndara në objektiva të përgjithshëm dhe specifikë në lidhje me njohuritë fituara, pajisjen me aftësi në kërkimin shkencor, si dhe kompetenca profesionale dhe akademike që fitojnë studentët në përfundim të PS dhe që synojnë futjen e tyre në tregun e punës ose vazhdimin në një program të ciklit të tretë.<br><br>Objektivat e pergjithshme te ketij PS sipas rregullores mesimore jane :<br><br>1. Ky PS ofrohet ne perputhje me misionin, qellimet dhe strategjine per zhvillim te AU. |

| | |
|---|---|
| studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | 2. Programi eshte hartuar ne perputhje me nevojat e tregut te punesdhe me zhvillimin ekonomik te vendit, ofrohet ne perputhjeme objektivat kombetaredhe nderkombetare dhenuk bie ndesh me interest dhe vlerat kulturore kombetare.<br>3. Programi ofrohet ne module te vecanta dhe eshte I vleresuar me kredite sipas sistemit Europian te transferimit dhe grumbullimit te krediteve (ECTS)<br>4. Programi ju adresohet te diplomuarve qe zoterojne diplomen "Bachelor" duke ofruar njohuri te thelluara teorike dhe praktike si dhe trajtim per kerkim shkencor apo avancim akademik ne programet e doktoratures ne Finance, Banke, Menaxhim, Kontabilitet, Menaxhim Korporatash, Menaxhim te Institucioneve Financiare etj.<br>5. Programi ka ne baze kerkimin shkencor dhe krijon baza te qendrueshme njohurish per te vazhduar me pas me studimet e ciklit te trete, duke perfshire aftesimin per kerkimin shkencor dhe plotesimin e parakushteve per pranimin ne ciklin e trete te studimeve.<br>6. Programi mbeshtetet ne pervojen disavjecare dhe praktikat e mira te vendeve europiane. Ai eshte nderkombetarisht konkurrues per nga elementet qe permban duke afirmuar vlerat e arsimit universitar ne Shqiperi.<br>Objektivat specifike te programit sic shfaqen ne rregulloren mesimore jane:<br>1. Strukturimi I nje qasjeje te thelluar analitike nepermjet njohurive te ofruara dhe pajisjes se te diplomuarve me instrumentet e nevojshem shkencor ne analizen e hollesishme te sistemit ekonomik ne teresi, politikave ekonomike, menaxhimit te institucioneve bankare dhe jo bankare, zhvillimit te institucioneve dhe komponenteve te qeverisjes, te projektuara ne dinamiken e zhvillimit te tyre ekonomik dhe bashkekohor.<br>2. Pergatitjes se tezes se diplomes duke synuar qe te jete sa me kuruar, e plote, rezultat I nje kerkimi te mirefillte shkencor ne fushen e ekonomise.<br>3. Pajisjes se te diplomuarve me aftesi teorike dhe analitike te performances menaxheriale nepermjet kerkimit shkencor te aplikuar, duke respektuar rigorozisht raportin e standarteve dhe rregullave te testimit empirik te problematikave qe lidhen me sferen bankare mundeson se pari formimin e studjuesve serioz me njohuri te mjaftueshme per t'u adaptuar edhe si menaxher financash per bizneset ne pergjithesi.<br>4. Zhvillimit te aftesive per arsyetime llogjike me baze teorike dhe empirike, kompetenca argumentuese dhe keshilluese per institucionet financiare, institucionet financiare jobankare, sistemin bankar, |

| | |
|---|---|
| | organizatat joqeveritare nderkombetare dhe te gjithe aktoret e interesuar ne keto fusha.<br>5. Ofrimit te njohurive dhe ekspertizes se perftuar gjate dy viteve te studimit finalizohet me krijimin e nje grupi te diplomuarish te afte per te punuar si menaxher, keshillues biznesi, ekonomiste prane kompanive vendase, dhe te huaja, apo qendrave te ndryshme kerkimore, konsulente apo eksperte te treguesve ekonomike prane organizmave te ndryshem qeveritare dhe jo-qeveritare, kombetare dhe nderkombetare, aspirante te studimeve te avancuara ne fushen e menaxhimit financiar apo tregut te kapitaleve.<br>Gjykuar nga objektivat e mësiperm, në perfundim të ketij programi studenti do të zotërojë kapacitete për t'u punësuar në tregun financiar por edhe për të thelluar me tej njohuritë me studime te ciklit të tretë.<br>Këto objektiva i gjejmë të trupëzuar në kurrikulën që ofrohet, organizimi i planit mësimor, ndarja e moduleve në vite, syllabuset, orët teorike dhe ato praktike, laboratorët dhe praktikat profesionale.<br>GVJ konstaton që objektivat e PS janë të përcaktuara qartë, janë të përshtatshme për këtë cikël studimesh dhe bëjnë të mundur që studentët të formohen në përputhje me kërkesat e tregut.<br>**[Aneksi:H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 4, neni 6, neni 8 dhe neni 9]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni GVJ konstatoi që Departamenti i Shkencave Ekonomike ka kryer një studim tregu në vitin 2019, duke kombinuar të dhëna makroekonomike në lidhje me punësimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit dhe duke indikuar mundësitë per zhvillim për AU. Në vijim ka analizuar të dhënat për studentët e diplomuar dhe ka arritur në dy konkluzione: [1] se ndërmarrjet e mëdha janë ato të cialt rekrutojnë më shumë të diplomuar dhe se [2] mungesa e bashkëpunimit midis IAL-ve dhe ndërmarrjeve për të punësuar të diplomuarit.<br>GVJ mendon se të gjitha këto të dhëna janë të vlefshme dhe e ndihmojnë departamentin për të parashikuar ecurinë e programit në të ardhmen dhe sugjeron që të analizohet edhe pjesa e vazhdimit të studentëve në ciklin e tretë, pasi ky është një nga objektivat e përgjithshëm të programit. Po ashtu është ë rëndesishme që studimet e tregut të jene periodike dhe në bazë krahasuese për të evidentuar ndryshimet nga kalimi i kohës.<br>**[Aneksi: 1.2.a Studimi i Tregut të Punës.pdf; 1.2.b Pyetësori i aplikuar për studimin e tregut të punës.pdf ]** |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë | Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit të studimit GVJ konstatoi se objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e PS janë të orientuara nga nevojat e tregut të punës. Në përfundim të studimeve programi i garanton studentëve përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që u mundësojnë |

| | |
|---|---|
| përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | atyre futjen në tregun e punës ose vazhdimin në ciklin e tretë të studimeve. Tregu i punës për studentët e diplomuar në këtë program është mjaft i gjerë. Ata mund të punësohen kryesisht në sektorin privat bankar, si analist të dhënash, analist kredie, konsulent financiar apo menaxherial.<br>**[Aneksi:H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 4]** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | Për përpilimin e programit të studimit dhe sipas RVB dhe intervistës me drejtuesit e Njësive kryesore janë marë parasysh programe të ngjashme të ofruara nga Universitetet publike në vend. Qëllimi, sic edhe u përmend gjatë intgervistës nuk ishte krijimi i një program i specializuar, por i një programi qe lejon hapesire tek studentët për karrierë akademike ose karriere në sistem; pra t'i përmbushur të dyja fushat. Nuk ka ndonjë evidencë që indikon krahasim të këtij programi studimi me programe të tjera ndërkombëtare. |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | Programi i studimit është hartuar bazuar në legjislacionin shqiptar i cili është në përputhje më legjislacionin dhe direktivat e BE.<br>Programi është në përputhje me kërkesat e Bolonjës dhe suplementi i diplomës bazohet në modelin e hartuar nga Këshilli Europian. |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Sipas programit të studimit në lëndët plotësuese parashikohet "praktika profesionale" me 12 kredite në përputhje të kërkesave të ligjit. Këtë detyrim studentët e plotësojnë duke kryer praktikën ne institucionet ku ata aktualisht punojnë ose në institucione të tjera, për të cilat Institucioni ofron mundësi, ose sipas mundësive që ata privatisht disponojnë.<br>**[Aneksi: R.2 Procedura e rishikimit të kurrikulës Msc Menaxhim Bankar, 2019.pdf; 1.5 Syllabusi i lëndës praktikë mësimore.pdf]** |
| **Kriteri 7.** Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit. | PS ofrohet vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa modulet apo materialet e studimit mund të jenë në gjuhën shqipe ose angleze. Ky program aktualisht nuk ka studentë të huaj apo të ardhur nga mobilitetet. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 8.** Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze | Dokumentacioni dhe aktiviteti i zhvilluar i programit ruhet në gjuhën shqipe. Nëse kërkohet ky dokumentacion për efekt procedurash në gjuhën angleze, sipas RVB i jepet studentit i përkthyer në bazë të një tarife. Ky kriter nuk plotësohet. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** | |
| | | | **X** | | |

| **Standardi I.4** <br> **Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | AU është një prej universiteteve të vjetra private në treg i krijuar që në 2004. Gjatë këtyre viteve ka fituar experience në fushën e arsimit privat dhe në krijimin e bazës infrastukturore dhe akademike për të ofruar programet e tij. <br><br> GVJ konstatoi se AU ka në dispozicion burimet njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të tij. Stafi i Fakultetit është me përvojë dhe i kualifikuar [pjesa më e madhe] në fushat specifike qe mbulojnë këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB-së, si dhe vizita ne Zyrën e burimeve njerëzore, sikurse dhe në takimet me stafin u vu re qe rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kritereve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi. Tabelat e përfshira në RVB dhe Aneksit mbi ngarkesën dhe background-in e pedagogëve, dëshmojnë se mësimdhënia në këtë program është kryer: <br><br> (a) Në vitin 2018-2019 nga 10 pedagogë: 7 PAE dhe 3 PAK, nga të cilët 3 janë me gradë Dr /PHD dhe të tjerët me tituj më të lartë. <br><br> (b) Në vitin 2019-2020 nga 10 pedagogë: 7 PAE dhe 3 PAK, nga të cilët 3 janë me gradë Dr/PHD dhe të tjerët me tituj më të lartë. <br><br> (c) Në vitin 2020-2021 nga 8 pedagogë: 6 PAE dhe 2 PAK, nga të cilët 2 janë me gradë Dr /PHD dhe të tjerët me tituj më të lartë. <br><br> Ne nivel fakulteti vihet re një rënie e numrit të stafit nga 112 në 88 pedagogë gjithsej në 2020-2021. Për Departamentin e Shkencave Ekonomike specifikisht të dhënat janë: <br><br> ● 22 PAE dhe 22 PAK në 2018 – 2019 <br> ● 19 PAE dhe19 PAK në 2019 – 2020 <br> ● 15 PAE dhe 15 PAK në 2020 – 2021 |

| | |
|---|---|
| | Sipas intervistës me drejtuesit e Njësisë kryesore, stafi akademik ka edhe background praktik [nga sektori bankar] dhe disponon kapacitetin për të ofruar lëndët e këtij programi.<br><br>**[Aneksi: 2.5.a Ngarkesa mësimore stafi akademik 2018-2019.pdf; 2.5.b Ngarkesa mësimore stafi akademik2019-2020, S.I.pdf; 2.5.c Ngarkesa mësimore stafi akademik 2020-2021, S.I.pdf; 2.6 CV e stafit Akademik, programet MSc.pdf;** |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimit Msc në Menaxhim Bankar është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe ekonomike, i cili sipas nenit 4 te rregullores ka si qellim "organizimin e procesit te mesimdhenies dhe të kërkimit shkencor, zhvillimin dhe përhapjen në nivele më të larta intelektuale të dijes në shkencat e arkitektures, inxhinierive dhe shkencave ekonomike" .<br><br>Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit te lartë dhe aktet nenligjore ne fuqi dhe udhezimeve kombetare e europiane.<br><br>Gjithashtu, emërtimi i këtij program është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit<br><br>**[Aneksi: 1.6 Rregullore e FSHAE.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf]** |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje | GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Shkencave Ekonomike, si njësia bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane.<br><br>**[Aneksi: 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Detyrat dhe përgjegjësitë mbi hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS janë të përcaktuara në rregulloren e AU, në rregulloren e Fakultetit, si dhe në rregulloren e Departamentit.<br><br>Detyrat dhe përgjegjësitë janë të ndara dhe të harmonizuara midis strukturave organizative, organeve dhe autoriteteve drejtuese. Sipas këtij dokumentacioni është departamenti ai që propozon programet e studimit, harton planet mësimore, propozon kriteret e pranimit dhe përzgjedh studentët fitues.<br><br>GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara më së miri në aktet rregullatore. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS dhe kjo sigurohet përmes roleve dhe përgjegjësive të qarta që kanë përgjegjësi i njësisë bazë, përgjegjësit e grupləndëve/koordinatorët dhe titullarët e lëndëve.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; 1.4 Rregullore Albanian University.pdf; 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf]** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe praktikave profesionale RVB ka paraqitur tabelën 5 ku përfshihen marreveshjet e AU dhe institucioneve private apo IAL-ve të tjera me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. AU ka marrëveshje bashkëpunimi me 15 institucione private për praktikat mësimore dhe ka bashkëpunuar me 11 IAL në aktivitete të tjera.<br><br>Nga dokumentacioni i ofruar ne portal kemi një marreveshje bashkëpunimi me AMF.<br><br>**[Aneksi: 1.8 Marrëveshje me AMF.pdf, RVB, tabela 5]** |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit "Master i shkencave"/ "Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron. | Praktika profesionale është pjesë kurrikulës për PS. Në takimin me drejtuesit e Njësisë kryesore dhe njësisë bazë GVJ u informua që institucioni ka marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës për programin e studimit. Nga institucioni vendosen pedagogët të cilët ndjekin procesin dhe udhëzojnë studentët në lidhje me hapat dhe procesin që duhet të ndjekin. Edhe nga intervista me studentet është theksuar se kanë një pedagog udhezues, i cili i drejton në lidhje me praktiken profesionale. Per sa i përket marrëdhënies se institucionit me punëdhënësin ato lidhen nëpërmjet një marrëveshjeje dhe plotësimit të dokumentacionit perkates nga punedhenesi ne mbarim te praktikes. |

| | |
|---|---|
| | **[Aneksi: 1.8 Marrëveshje me AMF.pdf, RVB, tabela 5, 1.5 Syllabusi i lëndës praktikë mësimore.pdf, 1.7 Formulari i ndjekjes së praktikës mësimore.pdf]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. | Institucioni ka paraqitur një listë bashkepunimi me institucione dhe IAL të tjera, duke shënuar bashkëpunimet për konferencat shkencore me AMF dhe Kolegjin Universitar Qirjazi. IAL inkurajon stafin dhe studentët të marrin pjesë ne aktivitete të tilla me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore Në bashkëpunim me keto institucione IAL ka organizuar konferencën shkencore dhe studentore dhe punime shkencore te cilat me pas jane publikuar ne revisten shkencore te Universitetit. Nuk rezulton të ketë marrëveshje për mobilitete të stafit apo studentëve, gjë që GVJ e ka konfirmuar edhe pas intervistave me stafin dhe studentet.<br><br>**[Aneksi: 1.8 Marrëveshje me AMF.pdf, 1.10 Studentët pjesëmarrës në Konferencën me AMF-24.05.2019.pdf, 5.5 Aktivitet shkencor, Konferenca Dhjetor 2018.pdf]** |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit | Departamenti i Shkencave Ekonomike diskuton periodikisht në lidhje më marrëveshjet e bashkëpunimit duke ndarë eksperienca dhe ide.<br><br>Nuk ka një raport të vecantë e të mirëfillte që analizon marrëveshjet dhe përfitimet prej tyre. Në raportin e Departamentit përfshihet lista e bashkëpunimeve, por jo një analizë e qartë e përfitimeve nga ato. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.6**<br>**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve. | Në mbështetje të kërkimit shkencor, AU organizon në të përvitshme Konferencë Ndërkombëtare në bashkwpunim me IAL të tjera, por edhe me institucione si AMF. Sipas raportit vjetor të Departamentit personeli akademik dhe studentët inkurajohen për të mare pjesë në këto evente, duke i mbështetur edhe financiarisht.<br><br>Po ashtu, AU boton revisten OPTIME, ku përfshihen veprimtaritë shkencore të stafit akademik.<br><br>**[Aneksi: 5.5 Aktivitet shkencor, Konferenca Dhjetor 2018.pdf; 3.4 Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare 2019-2020.pdf; R.4.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf; R.4.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf; 2.8 Revista Optime.pdf]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Vlerësimi i rezultateve në fushën e kërkimit shkencor kryhet nga Njësia bazë që është Departamenti. Formulari i vlerësimit të stafit akademik përfshin edhe aktivitetin shkencor. Te gjitha vlerësimet përfshihen në raportin vjetor të Departamentit.<br><br>**[Aneksi: Formulari i vlerësimit të stafit akademik PAE-PAK.pdf; 3.4 Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare 2019-2020.pdf; R.4.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019.pdf; R.4.b Raport vjetor DSHE 2019-2020.pdf;]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Institucioni ndjek disa praktika të mira në lidhje me promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor duke i botuar ato në Revistën Optime ose duke i mbështetur financiarisht pedagogët për të botuar në revista të tjera shkencore jashtë, sic na është përmendur në takimet me Institucionin. Departamenti përkatës harton një plan të aktiviteteve kërkimore shkencore, në kuadër të zhvillimit institucional, ku përfshihet edhe kërkimi shkencor. Nevojitet një përpjekje më e organizuar në lidhje më promovimin e rezultateve në kërkimin shkencor.<br><br>**[Aneksi: 3.8 Plani i aktiviteteve kërkimore shkencore të DSHE 2020 – 2021.pdf]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese. | Institucioni ka hartuar një Kod Etike, i cili ne nenin 4, i referohet të drejtës së autorit, shfrytëzimit dhe riprodhimit të veprës, duke mbrojtur pronësinë intelektuale dhe praktikën e mirë në veprimtarinë botuese. GVJ mendon se kjo politikë duhet hartuar në kontekstin e botimit të Revistës Optime me detaje që i përkasin procesit të botimit.<br><br>**[Aneksi: 1.9 Kodi Etikës.pdf, neni 4]** |
| **Kriteri 5**. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor | Institucioni i inkurajon studentët për pjesëmarrje në konferenca, si psh ajo e organizuar me AMF. Po ashtu i mbështet në lidhje me tematikat e tyre të kërkimit për diplomimin, duke ju vendosur nje pedagog udhëheqës në dispozicion. GVJ mendon se institucioni mund të bëjë më shumë përpjekje të organizuar në lidhje me këtë fushë.<br><br>**[Aneksi 1.10 Studentët pjesëmarrës në Konferencën me AMF-24.05.2019.pdf; 3.9 Lista e pedagogëve udhëheqës.pdf]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE

| **Standardi II.1**<br>**Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve [ECTS]. | Plani mësimor për PS Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" përmban 14 Module teorike, Praktikën mësimore, si dhe punimin e diplomës. Gjithsej ka 120 kredite dhe organizohet në 4 semestra.<br><br>Të gjitha modulet kanë të përcaktuar ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, si dhe numrin e krediteve. Plani mësimor gjithashtu harmonizon më së miri peshën ndërmjet tipeve të veprimtarive. Dokumentacioni mbi PS pasqyron kërkesat sipas Ligjit nr.80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018.<br><br>Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet me mbrojtje të temës së diplomës **[Evidencë 3.9 Lista e pedagogëve udhëheqës.pdf ; 3.10 Formati i vlerësimit të temës së diplomës.pdf]**<br><br>Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur GVJ konstatoi që PS është organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve [ECTS].<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 6]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Plani mësimor përmban module të cilat synojnë dhënien e njohurive dhe shprehive në fusha të veçanta si *Financa e Korporatave* dhe *Menaxhimi Financiar*. Kjo realizohet kryesisht përmes lëndëve bazë, dhe atyre ndërdisiplinore. Mbëshetur në planin mësimor, syllabuset e lëndëve, takimet me personelin akademik dhe studentët GVJ konstatoi që PS synon formimin e shprehive të veçanta në specialitet që lidhen me menaxhimin financiar dhe financat e korporatave. Në opinionin e GVJ kjo qasje iu mundëson studentëve marrjen e njohurive në disa specialitete dhe lehtëson punësimin e tyre si specialistë në fusha të ndryshme, por edhe siguron vazhdueshmërinë e studentëve në programet e ciklit të tretë, duke plotësuar kështu edhe një prej objektivave të programit.<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 6]** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Plani mësimor përmban 9 module në grupin e lëndëve karakterizuese, të cilat japin njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit bankar. Plani parashikon gjithashtu dhënien e njohurive në ekonometri dhe financë korporatash, të cilat i ndihmojnë studentët të kuptojnë dhe analizojnë modele të ndryshme ekonomike/ financiare, të realizojnë punë të pavarur, të shprehin qëndrimin e tyre në lidhje me teoritë financaiare dhe sistemet financiare. |

| | |
|---|---|
| | **[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 6]** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe nga rishikimi i tij i kryer pas rekomandimit të fundit të grupit të mëparshëm të vlerësimit, programi ka përfshirë lëndë të avancuara në fushën e menaxhimit bankar, si psh Menaxhim i Riskut Bankar, Ekonometri në Financë, Etika e Biznesit Bankar, Marketing Bankar, Kontabilitet dhe Teknikë Bankare, E Drejta Bankare. Këto ndryshime të kombinuara edhe me lëndët ekzistuese formuese të programit si Mbikqyrje Bankare, Drejtimi Financiar Ndërkombëtar apo Auditimi Bankar i kanë dhënë programit një profil shumë të specializuar në fushën e Menaxhimit Bankar. Ky specializim në këtë fushë synon në arritjen e kompetencave dhe aftësive të avancuara.<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 6; R.2 Procedura e rishikimit të kurrikulës Msc Menaxhim Bankar, 2019.pdf]** |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me drejtuesit e Njësisë kryesore dhe Njësisë bazë rezultoi që PS respekton të gjitha elementet sipas përcaktimeve në VKM 41, datë 24.01.2018.<br><br>PS realizohet në 4 semestra me nga 30 ECTS secili, duke plotësuar ngarkesën prej 120 ECTS në përfundim të studimeve. Ngarkesa në auditor është 21 orë/javë për 4 semestra. Plani mësimor përmban 14 lëndë, praktikën mësimore dhe punimin e diplomës. Sipas numrit të ECTS lëndët grupohen si më poshtë:<br>- 11 lëndë me 6 kredite<br>- 3 lëndë me 8 kredite;<br>- Praktika profesionale 12 kredite<br>- Detyrimi përmbyllës (Diploma) 18 kredite.<br><br>Komponentët mësimor janë të pasqyruara në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve.<br><br>GVJ është i mendimit që konvertimi i ECTS në orë mësimore dhe komponentë mësimor është në përputhje më aktet nënligjore dhe i pasqyruar saktë.<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf]** |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Në planin mësimor janë pasqyruar të gjitha ndarjet sipas veprimtarive formuese [nga A-E]. GVJ konstaton që pesha e secilës veprimtari ndaj totali është si më poshtë:<br>A. lëndët bazë [kategoria A (5-10%)] kanë 12 kredite/120 = 10% të krediteve;<br>B. lëndët karakterizuese [kategoria B (50-60%)] kanë 60 kredite /120 = 50% të krediteve;<br>C. lëndët integruese [kategoria C (12-20%)] kanë 18 kredite /120 = 15% të krediteve; |

| | |
|---|---|
| | D. lëndët plotësuese [kategoria D (10%)] kanë 12 kredite /120 = 10% të krediteve;<br>E. detyrimet përmbyllëse [kategoria E (10-15%)] kanë 18 kredite /120 = 15% të krediteve.<br>GVJ konstaton që kategoritë e veprimtarive formuese janë në përputhje me përcaktimet dhe kufijtë orientues të VKM 41. Grupimi i lëndëve sipas veprimtarive formuese është i përshtatshëm për këtë program studimi.<br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf, RVB, tabela 9]** |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj | PS ka përcaktuar 18 kredite për realizimin e diplomës dhe aktivitetit kërkimor në kuadër të zhvillimit të saj qe perbejne 15% te totalit te krediteve dhe jane konform ligjit dhe te pershtatshme per kete program studimi.<br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf, RVB, tabela 9]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | AU përbëhet nga 3 njësi kryesore [Fakultete], një ndër të cilat është dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Pjesë e këtij Fakulteti është Departamenti i Shkencave Ekonomike i cili ofron këtë program studimi.<br>AU është akredituar institucionalisht me vendimin e BA Nr. 01, datë 24.01.2020 "*Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat “Albanian University*”, me kohëzgjatjen prej 3 [tre] vite. PS është akredituar me VBA Nr. 81, date 27.10.2018, me kohëzgjatje 2 vite akademike, i vlefshëm deri në 30.09.2020.<br>**[Aneksi: Aplikimi, të dhënat institucionale, e-ascal]** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.<br>**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore | Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe njësisë bazë janë të përcaktuara në rregulloren e AU dhe të Fakultetit. GVJ konstatoi që organizimi i njësisë kryesore/bazë është në përputhje me ligjin Nr 80/2015 "Për arsimin e lartë".<br>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, si njësia kryesore e këtij programi, bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe ofron programe studimore në nivele të ndryshme *(L. 80/2015, Neni 23, pika 1).* |

<table>
<tr>
<td>dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</td>
<td>Ky Fakultet përbëhet nga tre njësi bazë:<br>- Departamenti i Shkencave Ekonomike<br>- Departamenti i Art Disajn<br>- Departamenti i Inxhinierive<br><br>Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, si dhe në zbatim të rregullores së AU, Departamenti i i Shkencave Ekonomike ka emëruar koordinator të programit të studimit, Drejtuesen e Departamentit me titullin Prof.Assoc.<br><br>AU ka krijuar struktura për koordinimin e grup-lendëve me natyrë të ndryshme duke përcaktuar pedagogë të ndryshëm ne lidhje me to.<br><br>[Aneksi: 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf]<br><br>[Aneksi: 1.4 Rregullore Albanian University.pdf;</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</td>
<td>Referuar të dhënave të institucionit per vitin 2020-2021, Fakulteti i Shkencave Ekonomike ka në përbërjen e tij 40 PAE. 34 PAK, dhe 18 PNA dhe PA.<br><br>Dekani i Fakultetit ka titullin Profesor i Associuar.<br><br>Departamenti i Shkencave Ekonomike përbëhet staf akademik si me poshte sipas titujve per periudhen e shqyrtuar:<br><br>
<table>
<tr><th rowspan="2">Departamenti i Shkencave Ekonomike</th><th colspan="2">2018-2019</th><th colspan="2">2019-2020</th><th colspan="2">2020-2021 (sem I)</th></tr>
<tr><td>PAE</td><td>PAK</td><td>PAE</td><td>PAK</td><td>PAE</td><td>PAK</td></tr>
<tr><td>Prof.Dr</td><td></td><td>3</td><td></td><td>3</td><td></td><td>1</td></tr>
<tr><td>Prof.Assoc</td><td>4</td><td>7</td><td>4</td><td>4</td><td>4</td><td>5</td></tr>
<tr><td>Dr/PHD</td><td>8</td><td>6</td><td>7</td><td>6</td><td>6</td><td>4</td></tr>
<tr><td>Msc (dr ne proces</td><td>4</td><td></td><td>3</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Msc</td><td>6</td><td>6</td><td>5</td><td>5</td><td>4</td><td>4</td></tr>
<tr><td></td><td>22</td><td>22</td><td>19</td><td>19</td><td>16</td><td>15</td></tr>
</table>
<br>Përgjegjësja e Departamentit ka gradën Profesor i Associuar.<br><br>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi që njësia kryesore/bazë për PS përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik për të gjithë periudhën 2018-2020.<br><br>[Aneksi: RVB, tabela 1.3]</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</td>
<td>Njësia kreysore/bazë ka në përbërjen e saj PNA dhe PA, të cilën mbështesin realizimin e objektivave të programit. Ky program nuk ka orë laboratorike, ndërsa praktika mësimore realizohet nga studentët nëpër biznese të ndryshme.<br><br>[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf, RVB, tabela 1.3 ]</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.<br><br>**Kriteri 7.** Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit | Koordinatori i programit të studimit është Drejtuesja e Departamentit, ndërsa per praktikat profesionale caktohet një pedagog i cili udhëzon dhe ndihmon studentët në cdo hap të praktikës së tyre.<br><br>I gjithë dokumentimi i PS pasqyrohet në raportin vjetor të Departamentit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Mbështetur në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin AMS dhe në vizitën në IAL, GVJ konstatoi që njësia kryesore dhe ajo bazë kanë dokumentacion të plotë për organizimin e këtij PS si: rregullorja e departamentit, rregullorja e programit të studimit, plani mësimor, ngarkesa mësimore e personelit akademik, syllabuset e lëndëve, etj.<br><br>GVJ konstatoi gjithashtu që ky informacion është i përditësuar duke reflektuar të gjitha ndryshimet në zbatim të ligjit nr.80/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.<br><br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; 1.4 Rregullore Albanian University.pdf; 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, RVB, tabela 1.3]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.<br><br>**Kriteri 3.** Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Plani mësimor është organizuar në lëndë [14 lëndë], praktikë mësimore dhe në detyrime përmbyllëse [diploma]. Veprimtaritë formuese janë të organizuara në pesë kategori formuese [A-E].<br><br>Kohëzgjatja e PS është 2 vjet, 4 semestra dhe 120 ECTS. Kreditet janë 30 ECTS për semestër ose 60 ECTS për vit akademik.<br><br>Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket lënda, numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur lënda |

| | |
|---|---|
| | zhvillohet. Lëndët e programit të studimit kanë, 6 ose 8 kredite. Praktika ka 12 kredite Mbrojtja e diplomës ka 18 kredite.<br><br>Grupimi i lëndëve sipas veprimtarive formuese është i përshtatshëm për këtë program studimi.<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf, RVB, tabela 9]** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Plani mësimor përmban informacion të plotë për ndarjen e lëndëve në leksione/seminare, orët në auditor/dhe jashtë auditorit, si dhe kreditet për çdo veprimtari. Në syllabuset e lënëdëve ka informacion të plotë mbi detyrimet për frekuentim nga ana e studentëve dhe format e kontrollit të dijeve. Kontrolli i dijeve realizohet në mënyrë të vazhdueshme.<br><br>Frekuentimi/ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, [Evidencë H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf, neni 15 dhe 25], dhe risillen sipas specifikave të lëndëve edhe në syllabuset përkatëse [Evidencë 2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc në “Menaxhim Bankar”2020-2021.pdf].<br><br>Vleresimi i dijeve gjatë vitit bëhet si më poshtë:<br>- 10 % pjesëmarja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve<br>10% dorëzimi i detyrës së kursit<br>- 20% provimi i ndërmjetëm/moduli<br>60% provimi përfundimtar<br><br>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur:<br>- Për leksionet detyrimi është 75%<br>- Për seminaret detyrimi është 75%<br>- Për praktikat profesionale dhe projektet 100 %<br><br>Kur studenti ka munguar me arsye në jo me shume se 25% te seancave te rregullta te praktikes profesionale planifikohen deri ne dy sëance plotesuese per cdo session dhe lendë.<br><br>Studenti nuk pranohet ne sesionin e pare te provimit te nje lende kur ka kryer me shume se 25% mungesa ne seancat mesimore te asaj lende. Ne qofte se ka kryer deri ne 50% mungesa, pranohet ne sesionin e dyte. Nese ka kryer mbi 50% mungesa ne seancat mesimore, shpallet perserites.<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf, neni 15 dhe 25, RVB tabela 10, 2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc në “Menaxhim Bankar”2020-2021.pdf ]** |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen | Në rregulloren e PS dhe ne rregulloren e vecante per rregjistrimet dhe transferimet të AU, janë të përcaktuara kriteret që duhet të plotësojnë studentët |

| | |
|---|---|
| me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | për t'u pranuar në këtë program studimi , kushtet për ndërprerjen apo trasferimin e studimeve, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre.<br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, neni 10, 11, 13; 2.3 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve.pdf]** |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore [syllabuset e detajuara] për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit përmban syllabuset për të gjitha lëndët e planit mësimor. Mbështetur në dokumentacionin e ngarkuar në AMS, GVJ konstatoi që syllabuset janë përditësuar bazuar në modelin e përcaktuar me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 [pika 2.8, shtojca nr.2].<br>Syllabuset përmbajnë informacion mbi rezultatet e të nxënit, konceptet kryesore, temat, literatura, frekuentimi dhe format e vlerësimit, numrin e krediteve, ngarkesën në auditor të ndarë në veprimtari.<br>GVJ konstatoi se të gjitha syllabuset përmbajnë informacionin e nevojshëm.<br>**[Aneksi: 2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc në "Menaxhim Bankar"2020-2021.pdf]** |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht | Përmbjatja e programit të studimit është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet janë kushtëzuar dhe nga hyrja në fuqi e ligjit nr.80/2015 dhe akteve nënligjore, por edhe nga rekomandimet e grupit të jashtëm të vlerësimit, gjatë akreditimit të mëparshëm. Nevoja për ndryshime dhe përmirësime është diktuar dhe për të mundësuar specializimin dhe krijimin e programit sipas objektivave dhe kërkesave të tregut lokal.<br>GVJ konstatoi që rishikimi i programit të studimit është një proces ku përfshihen personeli akademik, autoritetet dhe strukturat drejtuese. Procesi është i dokumentuar sipas rregulloreve të institucionit. Dokumentacioni nuk është arkivuar edhe në gjuhën angleze.<br>**[Aneksi: R.2 Procedura e rishikimit të kurrikulës Msc Menaxhim Bankar, 2019.pdf]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave"/"Master i Arteve" është strukturuar në përputhje me | Mbështetur në dokumenatcionin e ngarkuar në AMS GVJ konstaton që PS është strukturuar në 4 semestra me 30 ECTS për çdo semestër. Në total për semestrin e parë dhe të dytë ka 610 orë në auditor dhe 890 orë studim individual; ndërsa në semestrin e tretë dhe të katert ka 636 orë në auditor dhe 864 orë studim individual. Ngarkesa mësimore javore në auditor është 21 orë/javë mesatarisht. |

| | |
|---|---|
| parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Struktura e vitit akademik përcaktohet sipas udhëzimeve të MASR dhe shpallet përpara fillimit të vitit akademik nga Rektori. GVJ konstatoi që ngarkesa e PS është strukturar në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>**[Aneksi: RVB tabela 10]** |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që programi është i fokusuar dhe ka përputhshmëri midis emërtimit të veprimtarive dhe lëndëve që përmban çdo veprimtari.<br><br>Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe vite akademike mban në konsideratë ndërvarësinë midis lëndëve të ndryshme, dhe është në funksion të thellimit të njohurive dhe aftësimit të studentëve për studime në ciklin e tretë/ose punësimin e tyre në sektorin publik dhe privat.<br><br>**[Aneksi: R.2 Procedura e rishikimit të kurrikulës Msc Menaxhim Bankar, 2019.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf, RVB tabela 11]** |
| **Kriteri 3.** Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Plani mësimor parashikon realizimin e 5 lëndëve në semestrin e parë, 4 në semestrin e dytë, 5 në semestrin e tretë dhe praktika dhe diploma në semestrin e fundit. Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe orët mësimore në dispozicion të secilës lëndë mundësojnë pajisjen e studentëve me njohuri për të kuptuar dhe interpretuar konceptet, parimet dhe modelete menaxhimit bankar, si të aplikojnë metodat sasiore dhe cilësore për të analizuar probleme të ndryshme bankare, të kuptojnë, interpretojnë dhe përdorin në jetën e përditëshme tregues të ndryshëm bankarë, të aplikojnë metoda të ndryshme dhe të interpretojnë gjetjet përmes grafikëve, tabelave, etj. Kreditet për çdo lëndë dhe ndarja e tyre midis leksioneve/seminareve mban në konsideratë vëllimin e njohurive të reja dhe aftësive që duhet të marin studentët, si dhe karakterin aplikativ të tyre. GVJ mendon që pajisja e studentëve me këto njohuri dhe aftësi mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional të tyre.<br><br>**[Aneksi: R.2 Procedura e rishikimit të kurrikulës Msc Menaxhim Bankar, 2019.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf; RVB tabela 11]** |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | PS është hartuar duke mbajtur në konsideratë programe të përafërta kryesisht kombëtare. Lëndët, emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit për të gjitha tipet e veprimtarive dhe në pjesën më të madhe të tyre i njëjtë me PS të ngjajshme.<br><br>Ngarkesa e punës së studentit është shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë të dy viteve akademike.<br><br>Në këtë kurrikul shpërndarja e krediteve në aktivitetet formuese është si më poshtë:<br><br>1. Leksione 42 ECTS /420 orë në auditor |

| | |
|---|---|
| | 2. Ushtrime(seminare) 29 ECTS/ 218 orë në auditor<br>3. Laboratorë 18 ECTS/ 270 orë në auditor<br>4. Detyra/Projekte/diplomë 19 ECTS/ 38 orë në auditor<br>5. Praktikë profesionale 12 ECTS/ 300 orë në auditor<br>Pra 35% të krediteve totale ka pergatitja teorike, pra leksionet dhe 65% e krediteve janë të lidhura me përgatitjen praktike përfshirë këtu edhe punimi i diplomës.<br>Orët në auditor ne jave, gjithsej 20.76, përbëjnë 41.52% të fondit total të orëve të këtij programi studimi. Orët jashtë auditorit (studim individual) përbëjnë 58.48% të ngarkesës totale.<br>Raporti teori praktikë, referuar orëve në auditor është: 41.52% e orëve në auditor i përkasin përgatitjes teorike (leksioneve) dhe 58.48% e orëve në auditor krediteve janë të lidhura me përgatitjen praktike përfshirë këtu edhe punimi i diplomës.<br>GVJ mendon që struktura e programit, lëndët, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë janë në përputhje me profilin e programit dhe të përafërta me programe të ngjashme ndërkombëtare.<br>**[Aneksi: R.2 Procedura e rishikimit të kurrikulës Msc Menaxhim Bankar, 2019.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf; RVB tabela 11]** |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Veprimtaritë formuese që zbatohen për këtë program studimit janë leksionet, seminaret dhe laboratoret. Ndarja e orëve midis tyre është përcaktuar mbështetur në numrin e ECTS si dhe karakterin formues të lëndës. Në varësi të lëndëve dhe orëve që kanë në dispozicion ndarja në formim teorik dhe praktik është në raportet 3/2/1 dhe 3/3/1. GVJ mendon që kjo ndarje mundëson përvetësimin e njohurive, arritjen e objektivave formues, lehtëson transferimin e studimeve brenda dhe jashtë vendit, mundëson mobilitetin e studentëve dhe i aftëson ata për të hyrë në tregun e punës.<br>**[Aneksi: R.2 Procedura e rishikimit të kurrikulës Msc Menaxhim Bankar, 2019.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf; RVB tabela 11]** |
| **Kriteri 6.** Syllabuset [programet e lëndëve/ moduleve] përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Programet e lëndëve [syllabuset] përditësohen cdo vit akademik nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga njësia bazë. Ndryshimet e miratuara i përcillen njësisë kryesore. Gjatë takimit me PAE GVJ u informua që ndryshimet zakonisht realizohen para fillimit të vitit akademik ose në fundin e vitit paraardhës. GVJ konstatoi që të gjitha programet e lëndëve janë përditësuar sipas formatit të VKM 41/shtojca 2. Literatura e detyruar dhe ndihmëse është përditësuar, por në rastin e literaturës shqip kushti i 5 viteve të fundit nuk mund të realizohet për të gjitha lëndët. Pavarësisht kësaj GVJ mendon që literatura e përzgjedhur për çdo lëndë është literatura e përshtatshme. |

| | |
|---|---|
| | **[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf; 2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc në "Menaxhim Bankar"2020-2021.pdf]** |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë. | GVJ është i mendimit që përmbajtja e PS garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synohen për një program studimi të ciklit të dytë.<br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf;]** |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që përmbajtja e PS iu mundëson studentëve të ndjekin studimet e ciklit të tretë në fushën e Financë-Bankë kryesisht. Formimi i studentëve përshtatet gjithashtu me nevojat e tregut të punës në profilin bankar.<br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf; 2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc në "Menaxhim Bankar"2020-2021.pdf]** |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Përmirësimet në PS kanë si shtysë përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. Strukturat drejtuese të njësisë bazë dhe njësisë kryesore për të realizuar këto ndryshime kanë marrë në konsideratë kërkimin e tregut, por nevojitet më tepër organizim në konsiderimin e opinioneve dhe propozimeve nga bashkëpuntorë dhe ekspertë të jashtëm si dhe opinionin e Alumni. |
| **Kriteri 10.** Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve | PS kombinon veprimtarite e formimit teorik dhe shkencor për të ofruar njohuri të avancuara dhe për të mbështetur studentët që do të vazhdojnë ciklin e tretë të studimeve [objektivat e përgjithshme të programit].<br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf; 2.2 Syllabuset e lëndëve të MSc në "Menaxhim Bankar"2020-2021.pdf** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Sipas RVB në këtë PS japin mësim personel akademik me tituj/grada si më poshtë: **[RVB, tab.7, fq.119].** |

| **Kualifikimi** | **2018-2019** | | **2019-2020** | | **2020-2021** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof | | **1** | | | | |
| Prof As | **4** | **2** | **4** | **1** | **4** | **2** |
| Dr.PhD | **3** | | **2** | **2** | **2** | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dr proc | | | | | | |
| Msc | | | | | | |
| **Totale** | **7** | **3** | **6** | **3** | **6** | **2** |

GVJ gjatë vizitës në IAL u takua me një pjesë të personelit akademik dhe konstatoi që i gjithë personeli i angazhuar në këtë PS përmbush kërkesat ligjore në fuqi.

**[Ligji Nr. 80/2015, neni 9, pika 6]**

**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv. Konkretisht [Evidenca 2.5.a Ngarkesa mësimore stafi akademik 2018-2019.pdf., 2.5.b Ngarkesa mësimore stafi akademik 2019-2020, S.II.pdf, 2.5.c Ngarkesa mësimore stafi akademik 2020-2021, S.I.pdf]:

| Viti akademik | % e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE |
|---|---|
| **2018-2019** | 72% (sem I)/ 100% (semII) |
| **2019-2020** | 80% (sem I)/ 100% (semII) |
| **2020-2021/sem I** | 80% (sem I) |

70% e personelit akademik që jep mësim në këtë PS është PAE, të gjithë pjestarë në Departamentin e Shkencave Ekonomike, të cilët mbulojnë ngarkesën më të madhe në këtë PS. Të tjerët janë PAE nga IAL të tjera.

Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrale që mban një pedagog per kete program është 1 lëndë, me një numër maksimal lëndësh semestrale 2 per programin perkates.

Ndersa ngarkesa totale vjetore per nje pedagog varion nga nje lende ne vit, ne 10 lende ne vit (referuar vitit te plote akademik 2019-2020).

**Kriteri në lidhje me ngarkesën mësimore dhe numrin e lwndwve/ moduleve që mund të mbulojë një pedagog nuk plotësohet.**

GVJ konstatoi që i gjithë personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie në këtë PS ka nivelin e kërkuar të kualifikimit dhe angazhim maksimal për zbatimin e PS.

**[RVB, tab.7, fq.119]**

**Kriteri 3.** Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë PS mbulon lëndë që përputhen me fushën e tyre akademike dhe kërkimore.

Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik GVJ konstatoi që pjesa më e madhe e tyre kanë kryer studimet e ciklit të dytë dhe të treë në fusha që përkojnë me lëndën/lëndët që mbulojnë në këtë PS.

Gjithashtu veprimtaria e tyre kërkimore pas doktoraturë përputhet me specifikën e lëndëve që ata mbulojnë në PS.

**[Aneksi: 2.6 CV e stafit Akademik, programet MSc.pdf]**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni i dhënë, praktika profesionale kryhet nga studentët tek institucionet me të cilat AU ka lidhur marreveshje (referuar tabelës 5 të RVB). AU ka caktuar një pedagog të vecantë i cili ndjek praktikën professionale të studentëve dhe i udhëzon ata. Parë nga këndveshtrimi i studentëve, sic ata konfirmuan, kjo metodë ishte ndihmuese për ta.<br><br>Për sa i përket punimit të diplomës ajo udhëhiqet nga pedagogë të caktuar sipas fushave, specifikave dhe gradës. Kjo shpërndarje kryhet nga Drejtuesi i Departamentit. Disa prej punimeve të studentëve janë paraqitur ne Kongresin studentor dhe janë botuar në Revistën Optime.<br><br>**[Aneksi: 1.5 Syllabusi i lëndës praktikë mësimore.pdf; 1.7 Formulari i ndjekjes së praktikës mësimore.pdf; 1.10 Studentët pjesëmarrës në Konferencën me AMF-24.05.2019.pdf; 2.7 Emërtimet e temave të diplomës MSc 2019-2020.pdf; 2.8 Revista Optime.pdf]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit | Plani mësimor për këtë program studimi parashikon punë në laborator për lëndët informatikë. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që Njësia kryesore kishte angazhuar staf akademik për mbështetjen e studentëve gjatë realizimit të punëve praktike. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | AU ka kryer një studim tregu në lidhje me të dhënat e tregut të punës kombinuar edhe me pyetësorë drejtuar studentëve të diplomuar. Nëpërmjet këtij informacioni AU përmirëson programet e veta në përshtatje të kërkesave të tregut të punës. Paralelisht stafi akademik i përfshirë edhe në institucione fiannciare jep kontributin e vet nëpërmjet opinioneve dhe propozimeve gjatë mbledhjeve të Departamentit.<br><br>**[Aneksi: 1.2.a Studimi i Tregut të Punës.pdf; 1.2.b Pyetësori i aplikuar për studimin e tregut të punës.pdf; 3.6 Mbledhje departamenti.pdf ]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. | AU ka një formular vlerësimi online të cilin studentët e përdorin për të shprehur opinionet e tyre në lidhje me mësimdhënien dhe programin e studimit. Po ashtu përfaqësuesi i studentëve është prezent në strukturat e |

| | |
|---|---|
| Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | AU. Nga takimi me studentët rezultoi se ata janë afër me pedagogët dhe shprehin lirshëm mendimin e tyre. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. | AU ka krijuar zyrën Alumni, e cila është përgjegjëse për të kontaktuar me studentët e diplomuar. Deri tani kjo zyrë ka krijuar kontakte të cilat I përditëson cdo 6 muaj, sic është konstatuar nga intervista eme personin përgjegjës. Gjithsesi AU nuk ka krijuar një proces të dokumentuar për të marë mendimet e të diplomuarve në lidhje me përmirësimin e programit. |
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi | AU dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike, referuar RVB ka kryer propozime për hapje të një masteri të ri professional dhe të programit të doktoraturësnë Ekonomi dhe Zhvillim të qëndrueshëm. Nuk ka informacion për bashkëpunime të vecanta me IAL apo institucione të tjera për hapjen e këtyre programeve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | PS ka të përcaktuar nëpërmjet rregullores së tij objektivat specifikë dhe të përgjithshëm të cilat bashkërendojnë me objektivat e institucionit, sic ato përcaktohen në planin e tij strategjik.<br>**[Aneksi: 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022.pdf , fq. 3; 1.4 Rregullore Albanian University.pdf; 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf; H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf]** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Departamenti i Shkencave Ekonomike administron të gjitha veprimtaritë qe lidhen me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në kuadër të lirisë akademike, e cila mbrohet objektivisht. Pjesëmarrja në takime, shprehja e opinioneve, rishikimi i syllabuseve, rishikimi i kurrikulës dhe aktivitete të tjera ku pedagogët përfshihen mbrojnë lirinë akademike. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Programi i studimit përbëhet nga lëndë me karakter praktik, të cilat angazhojnë studentët në projekte mësimore dhe përfshin punimin e diplomës i cili i nxit studentët të jenë pjesë e aktivitetit kërkimor.<br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar".pdf]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. | Programi i studimit synon përgatitjen shkencore të studentëve që synojnë ciklin e tretë të studimeve dhe si i tillë përfshin zbatimin e politikave studimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Por nje zbatim i tille kërkon përfshirjen në projekte rajonale dhe bashkëpunim ndërkombetar, gjë të cilën institucioni nuk e ka vërtetuar nga dokumentacioni i vënë në dispozicion.<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf]** |
| **Kriteri 5.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme | AU mbështet financiarisht kërkesat e Departamentit të Shkencave Ekonomike në lidhje me realizimin e objektivave të PS, duke përmbushur kërkesat për literaturë, pjesëmarrjen në konferenca etj.<br><br>**[Aneksi: 1.3 Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike.pdf]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.8**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | AU ka bërë një përpjekjë për t’u angazhuar në projekte kërkimore të reja, të cilat nuk kanë rezultuar të suksesshme deri më tani, sic është konfirmuar nga intervista me stafin. Objektivat e programit dhe përmbushja e tyre kryhet nga vetë Departamenti me motivacionin kryesor plotësimin e njohurive të thelluara për vazhdimësinë e studimeve në ciklin e tretë ose promovimin në tregun e punës.<br><br>**[Aneksi: H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”.pdf, 3.8 Plani i aktiviteteve kërkimore shkencore të DSHE 2020 – 2021.pdf]** |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Departamenti i Shkencave Ekonomike është angazhuar për të qenë pjesë e projekteve ndërkombëtare kërkimore, por deri më tani nuk ka patur projekte aktive ku të angazhojë staf dhe studentë me to.<br><br>**[Aneksi: Plani i aktiviteteve kërkimore shkencore të DSHE 2020 – 2021.pdf]** |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave | AU ka organizuar një konferencë vjetore ne Dhjetor të 2018-es dhe ka marë pjesë në kongresin studentor të AMF. Të dyja eventet jane kryer me objektiv promovimin e punës shkencore të stafit dhe studentëve të programit. Per shkak te COVID aktiviteti konferences vjetore nuk eshte kryer gjate vitit akademik 2019-2020 dhe as përgjatë 2020-2021 deri me tani. Janë kryer aktivitete të tjera ekstrakurikulare në vitin akademik 2019- |

| | |
|---|---|
| | 2020, nëpërmjet platformave online sipas evidences së ofruar nga institucioni.<br><br>**[Aneksi: 3.4 Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare 2019-2020.pdf]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

**Standardi III.1**
**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | Pasi u shqyrtua dokumentacioni i vendosur nga AU dhe faqja web e AU, si edhe pas komunikimit me zyrën e kurrikulave dhe vizitës në ambientet e AU, rezulton se ky institucion në rregulloren mësimore të Masterit të Shkencave në “Menaxhim Bankar” ka të detajuara informacionet mbi leksionet, seminaret/ushtrimet, detyrat e kursit, projekte, etj. Gjithashtu, faqja web e AU reflekton këto informacione dhe shërben si udhëzues për studentët në nivel institucional mbi informacionet rreth mësimdhënies.<br><br>Personeli akademik, krahas materialeve didaktike si raste studimore, slide, tekste shtesë etj, shfrytëzon pajisjet e teknologjike që gjinden në auditore, si PC dhe video-projektorë. Përdorimi i teknologjisë së informacionit e përmirëson më shumë procesin e nxënies dhe i bën studentët më pjesëmarrës dhe krijues në procesin mësimor dhe shërben si mjet i domosdoshëm për zhvillimin dhe aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies.<br><br>**[Aneksi H.3 - Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”]** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e | GVJ pas takimit me Dekanin, përgjegjësen e departamentit dhe Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [NJSBC], Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave [ZZHK] edhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se AU ka mekanizmat e nevojshëm për të kryer monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies në të gjithë elementët e saj si leksione, seminare, kurrikula, punë laboratorike dhe praktikë profesionale. Gjithashtu ka mekanizmat e feedback-ut përmes vlerësimeve semestrale të mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmës akademik në auditor nëpërmjet pyetësorëve, focus grupeve dhe raporteve të vetëvlerësimeve të pedagogeve. |

| | |
|---|---|
| metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.<br><br>**Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. | Referuar RVB-së dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezulton se në fund të çdo semestri, përpara sezoneve të provimeve, studentët përfshihen në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes pyetësorëve për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative, të cilët në dy vitet e fundit janë kryer online përmes platformës Google Forms.<br><br>Konstatohet se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe për përpunimin e të dhënave është Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [NJSBC], e cila ia vë në dispozicion Departamentit dhe përfundimet diskutohen në mbledhjen e radhës. Gjithashtu përfundimet iu dërgohen pedagogëve dhe departamentit përmes postës elektronike.<br><br>Rezultatet përmbledhëse nga NJSBC diskutohen në Senatin Akademik në nivel Universiteti.<br><br>**[Aneksi 1.4 – Rregullores së Albanian University, Aneksi R.4.a - Raport Vjetor DSHE 2018-2019, Aneksi R.4.b - Raport vjetor DSHE 2019-2020 dhe Aneksi 3.2 - Formati raport vetevleresimi i stafit akademik, raport semestral]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.<br><br>**Kriteri 2**. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e | Bazuar në RVB dhe në Planin mësimor, siç parashtrohet në Rregulloren mësimore u shqyrtua se në këtë program përdoren forma e mësimdhënies si leksione, seminare/ ushtrime, detyra kursi, praktika mësimore, si dhe organizohen leksione të hapura në fushat e zhvillimeve të tregjeve financiare ose teknikave bankare ndërkomëtare.<br><br>Programi i studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" ofrohet i organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite në përputhje me: Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, neni 70, pika [1].<br><br>Kohëzgjatja e programit të studimit është 2 vite akademike, e shtrirë në 4 semestra. Çdo semestër ka 15 javë mësimore; Orët mësimore në auditor janë: viti i parë 610 orë dhe viti i dytë 636; Ngarkesa minimale javore 20-25 orë.<br><br>Gjithashtu, stafi akademik i përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar mundësi, forma dhe metoda bashkëkohore alternative të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijes. Nga bashkëbisedimi me studentët u konstatua se përveç leksioneve, gjatë seminareve krahas kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve dhe diskutimeve, aplikohen edhe raste studimore e detyrat individuale me studentët. Kombinimi i rasteve studimore me mësimin teorik bën |

| | |
|---|---|
| aktiviteteve formuese në veçanti.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.<br><br>**Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | që studentët të jenë të punësuar në shumicën e rasteve pas përfundimit të Masterit të Shkencave në Menaxhim Bankar. Gjithashtu, detyra e kursit aplikon njohuritë e marra nga masteri në institucionet ku punojnë.<br><br>Nga vizita në institucion dhe nga dokumentet e shqyrtuara rezulton se Masteri i Shkencave në "Menaxhim Bankar" zbaton udhëzimet e MASR në lidhje me procesin e mësimdhënies, ngarkesës mësimore, etj, dhe personeli akademik përdor mjetet didaktike si raste studimore, slide, tekste shtesë, etj.<br><br>Gjithashtu, shfrytëzon pajisjet e teknologjike që gjënden në auditore, si PC dhe video-projektorë me synimin e përmirësimit të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies. Institucioni ofron postën elektronike përmes platformës Office 365 për një qasje online të didaktikës.<br><br>Gjithashtu, çdo fillim viti NJSBC organizon trajnime didaktike për stafin akademik siç evidentohet në dokumentave të ngarkuar nga AU<br><br>Nga informacioni i siguruar nga studentët gjatë vizitës në Departamentin e Shkencave Ekonomike, fushave të ekspertizës dhe eksperiencës së stafit, rezulton se stafi akademik është kompetent në lëndët specifike që mbulon dhe siguron transmetimin e njohurive, nëpërmjet përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit përkatës përcjell tek studentët rastet studimore dhe praktikat më të mira në fushën e menaxhimit banker.<br><br>Gjithashtu, personeli akademik përdor me kompetencë pajisjet në dispozicion të mësimdhënies si dhe angazhon studentët në detyra kursi, çeshtje inovative, diskutime dhe leksione të hapura me ekspertë të ftuar.<br><br>**[Aneksi H.3 - Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar"], [Aneksi 3.4 - Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare 2019-2020]. [Aneksi 3.5.a Axhenda e trajnimeve te stafit akademik 2018-2019 dhe Aneksi 3.5.b Axhenda e trajnimeve te stafit akademik 2019-2020].** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.<br><br>**Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.<br><br>**Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e | Rezulton se institucioni dhe stafi akademik vlerëson periodikisht format dhe metodat e mësimdhënies me qëllim përmirësimin e tyre metodave. Sugjerimet nga studentet që vijnë nga pyetësorët dhe fokus grupet janë në vëmendje të institucionit dhe stafit akademik.<br><br>GVJ konstatoi nga takimet me stafin, se në orët e mësimit, rëndësi u jepet seminareve/ ushtrimeve që zhvillohen në bashkëpunim me studentët, ku stafi akademik hap diskutime dhe i aftëson ata mbi nevojat e tregut të punës. Evidentohet se në këtë mënyrë nxiten debatet dhe mendimi kritik që garantojnë ndërveprimin dhe pjesmarrjen e studentëve për të zgjidhur probleme specifike të natyrës financiare të fushës së tij.<br><br>Nga informacioni i siguruar në takimin me studentët, gjatë vizitës në institucion, u konstatua se metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik inkurajojnë autonomi tek studentët. Studentët inkurajohen të ndërmarrin iniciativa në përzgjedhjen e detyrave të kursit të cilat zhvillohen në grup por dhe mbështeten nga pedagogët duke ndërtuar një marrëdhënie reciprociteti dhe respekti. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.<br><br>**Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.<br><br>**Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.<br><br>**Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit [fizike dhe elektronike], garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.<br><br>**Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga | Në bazë të **RVB, Aneksit 4.3 - Planimetrite** dhe vizitës në institucion rezulton se procesi mësimor dhe shkencor në AU realizohet në hapësira të përshtatshme, të cilat janë të pajisura me mjete dhe pajisje didaktike inovative. GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi gjithashtu se sallat e leksioneve/seminareve dhe laboratorëve janë të mjaftueshme dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike, që ndodhet në godinën qëndrore të AU në Bulevardin Zogu I, është një godinë e rikontruktuar dhe e përshtatshme plotësisht për të zhvilluar procesin mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar”.<br><br>Godinat janë të pajisura me zyra, mjedise shërbimi, mjedise për aktivitete të ndryshme, hapësira rekreative si dhe ambjente hidrosanitare.<br><br>Nga vizita në institucion, u konstatua se sallat në dispozicion të procesit mësimor të programit, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të nevojshme për të zhvilluar leksionet. Ambjentet janë të mjaftueshme për të zhvilluar në mënyrë efektive procesin mësimor. Të gjithë auditorët janë të pajisur me mjetet e nevojshme për të zhvilluar lekione si tavolina, kompjutera, videoprojektor etj. Në të gjitha godinën funksionon sistemi i internetit wireless, që është i disponueshëm për të gjithë.<br><br>GVJ konstatoi se Fakulteti disponon një bibliotekë që është e hapur nga e hëna në të premte [08:00-16:00] dhe ditën e shtunë [08:00-12:00]. Fondi i bibliotekës është 1.586 tituj tekstesh universitare dhe 246 tekste mësimore janë në fushën ekonomike [në shqip dhe gjuhë të huaj] në dispozicion të Departamentit të Shkencave Ekonomike.<br><br>Nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se për çdo lëndë programit, literatura bazë ofrohet në gjuhën Shqipe dhe përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. etj. Literatura gjendet fizikisht në bibliotekën e fakultetit në gjuhën shqipe dhe angleze apo në gjuhe të tjera të BE-së.<br><br>GVJ mendon se biblioteka e institucionit disponon mjaftueshëm literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe pasurohet vazhdimisht duke reflektuar ndryshimet e programit te studimit. |

| | |
|---|---|
| studentët gjatë procesit mësimor.<br><br>**Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.<br><br>**Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.<br><br>**Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line [e-learning] dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.<br><br>**Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. | Mjediset e bibliotekës kanë hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët dhe pedagogët dhe janë në dispozicion në një orar të përshtatshëm.<br><br>Gjithashtu, personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë libraritë on-line nga mjediset e laboratorëve dhe bibliotekës, që janë të pajisura me PC.<br><br>Konstatohet se studentët dhe stafi akademik i Masterit të Shkencave në Menaxhim Bankar të Departamentit të Shkencave Ekonomike ka akses në librarinë online “QUESTIA”, e cila disponon 83.000 libra akademikë dhe mbi 10 milion artikuj shkencorë.<br><br>Gjithashtu, DSHE ofron akses në libraritë online ERIC [Education Resources Information Center], Cambridge Journals [www.cambridge.org/core], http://z-lib.org.<br><br>Gjithashtu, u evidentua se biblioteka e AU, ndërmarrja botuese “Albanian University” Press dhe Revista e universitetit “Optime” ofrojnë botime periodike, të cilat ofrojnë literaturë të mjaftueshme për studime, teza apo kërkime shkencore.<br><br>Në godinën ku kryhen leksionet ka një laborator informatike që është në dispozicion të Departamentit. Në sallën e Laboratorit të Informatikës ndodhen 25 postacione që janë për përdorim të studentëve dhe lëndëve Informatikë, Menaxhim i Sistemeve të Informacionit, si dhe lëndëve të tjera si Statistika dhe Kontabiliteti Financiar. Laboratori ka të instaluar programet e nevojshme për fushën si paketën Microsoft Office dhe Financa 5.<br><br>Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme referuar programit dhe janë të disponueshme për detyra kursi, tema diplome, konferenca studentore etj. Sidoqoftë, ky laborator nuk është i dedikuar vetëm për programin për të cilin kërkohet vlerësimi, por për të gjithe programet e tjera në fakultetin e ekonomisë dhe jo vetëm. Pra, hapësira nuk është e mjaftueshme duke konsideruar numrin e lartë të kërkesave gjatë vitit akademik.<br><br>GVJ, nga bisedat me studentët dhe stafin akademik, vë re se personeli akademik dhe studentët e AU-së, përdorin sistemin informatik që disponon AU siç është emaili individual dhe zhvillimi i mësimit online përmes Platformës Microsoft Teams. Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 dhe semestrit të pare 2020-2021 leksionet janë kryer online përmes kësaj platforme. Personeli akademik përdorë emailet zyrtare me logon e AU për të komunikuar me studentët dhe për të dërguar materialet didaktike.<br><br>**[Aneksi 2.4 - Literatura e disponueshme në bibliotekën e FSHAE për DSHE]** |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave [në rastet kur ato zhvillohen], asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | GVJ konstaton se mbrojtja e diplomës në Masterin e Shkencave në “Menaxhim Bankar” bëhet me punim [tezë] diplome. Brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit njofton studentët që diplomohen atë vit mbi temat me anë të të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar. |

| | |
|---|---|
| | Përgjegjësi i Departamentit harton listën me pedagogët udhëheqës të mundëshëm sipas gradës shkencore dhe fushës së ekspertizës, ku studentët mund të zgjedhin pedagogun sipas preferencës së tyre.<br><br>Konstatohet se punimet më të mira të temave prezantohen në Konferencën e përbashkët që organizohet nga AMF siç evidentohet në materialin e ngarkuar në RVB. Disa punime janë dërguar për botim edhe në revistën universitare të AU "Optime".<br><br>**[Aneksi 1.10 - Studentët pjesëmarrës në Konferencën me AMF-24.05.2019]. [Aneksi 2.8 - Revista Optime].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

**Standardi III.4**
**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1**. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<br><br>**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.<br><br>**Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.<br><br>**Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Bazuar në RVB, vizitës në institucion dhe takimit me Dekanin, përgjegjësen e departamentit, Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [NJSBC], Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave [ZZHK], si edhe pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konkludon se AU ka ngritur struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura në funksion të procesit mësimor-kërkimor, të përcaktuara sipas standardet shteterore te cilesise si dhe standardet dhe udhezimet europiane per Sigurimin e Cilesise ne HEAL, funksionojnë si një sistem që përbëhet nga: Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave [ZZHK] dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin [KKM]. Këto njësi bëjnë përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhenie dhe mësimnxënie.<br><br>Gjithashtu, pyetësorët, focus grupet e organizuara, raporti i vetëvlerësimit të stafit akademik dhe raporti i vetëvlerësimit mbi programin e studimit garantojnë cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e të gjithë palëve.<br><br>GVJ konstatoi se Departamenti i Shkencave Ekonomike si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar", zhvillon përmes analizave periodike për të shqyrtuar situatën e përmbushjes së standardeve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ngarkon detyra rreth problematikave të konstatura, siç evidenton në dokumentin e RVB.<br><br>Gjithashtu, çdo fillim viti harton një strategji dhe plan masash vjetorë për të garantuar rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit dhe angazhimin në punën e vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie<br><br>Pasi u shqyrtua materiali i ngarkuar në RVB, rezulton se në fillim të viti akademik 2019-2020 NJSBC ka organizuar në nivel Universiteti një trajnim mbi përdorimin |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.<br><br>**Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.<br><br>**Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | e platformës Google Classroom, që u ka krijuar mundësinë personelit akademik të zhvillojë metoda të reja në mësimdhënie, duke përdorur teknologjinë dixhitale në përshtatje me zhvillimin e programit të studimit **[**<br><br>Stafi akademik në AU inkurajohet për të përdorur mjetet dixhitale të teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, që janë testuar për një semestër të plotë të mësimit online në vitin akademik 2019-2020. Gjithashtu, NJSBC organizon trajnime për stafin akademik, kryesisht atë të ri, për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe metodave didaktike më të reja.<br><br>Gjatë vizitës së tij në institucion, GVJ konstatoi se stafi akademik dhe ai ndihmës akademik përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Bankar angazhohet për mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe përmirësimit të saj dhe është gjithnjë në kontakt me studentët për të nxitur mësimnxënien tek ata dhe përgatitjen e tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës.<br><br>Gjithashtu, u konstatua se Departamenti i Shkencave Ekonomike organizon mbledhje të vazhdueshme në funksion të zbatimit të programit të studimit si dhe për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e praktikave më të mira.<br><br>Konstatohet se DSHE ka disa cikle leksionesh të hapura dhe fton lektorë për të referuar tema bashkëkohore në lidhje me programine studimit<br><br>**[Aneksi 1.4 – Rregullores së Albanian University, Neni 13; Neni 14, Neni 15; Neni 16]. [Aneksi 3.6 - Mbledhje departamenti]. [Aneksi 3.7 - Plani strategjik i zhvillimit të DSHE 2018-2019]. Aneksi 3.5.b - Axhenda e trajnimeve te stafit akademik 2019-2020]. [Aneksi R.4.a - Raport Vjetor DSHE 2018-2019, Aneksi R.4.b Raport vjetor DSHE 2019-2020 dhe Aneksi 3.8 - Plani i aktiviteteve kërkimore shkencore të DSHE 2020 – 2021].** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.<br><br>**Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, | Pas vizitës në institucion, takimeve me Dekanin, përgjegjësen e Departamentit, stafin akademik, studentët si edhe pasi u shqyrtua dokumentacioni i depozituar nga institucioni, GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në Rregulloren e Universitetit, në Rregulloren e Departamentit dhe në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar"<br><br>Në këto rregullore parashikohen të gjitha elelmentët e procesit të vlerësimit si:<br><br>- provimi përfundimtar 60 pikë [60%], |

| | |
|---|---|
| dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.<br><br>**Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | - provimi i ndërmjetëm 20 pikë [20%],<br>- ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, ushtrime 10 pikë [10%],<br>- detyra/projekte kursi 10 pikë [10%]<br><br>Gjithashtu, konstatohet se dijet e studentit kontrollohen nga pedagogu i lëndës përmes bashkëbisedimit, testimeve apo seancave të kontrollit të dijes<br><br>GVJ konstatoi se studentët informohen nga pedagogët e lëndës në fillim të semestrit për programin e lëndës, skemat e vlerësimit dhe përmbajtjen e syllabusit.<br><br>**[Aneksi 1.4 – Rregullore e Albanian University], [Aneksi 1.3 - Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike]; [Aneksi H.3 - Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar"]. [Aneksi 3.1 - Format syllabusi 2020-2021].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.<br><br>**Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.<br><br>**Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të | GVJ nga vizita që kreu në institucion dhe takimet me Dekanin, Përgjegjësen e Departamentit, stafi akademik, studentët si edhe nga dokumentacioni i depozituar nga institucioni konstatoi se mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në rregullore të posaçme siç janë Rregullorja e Universitetit, Rregullorja e Departamentit, dhe Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar.<br><br>Konstatohet se në këto rregullore parashikohen të gjitha elelmentët e procesit të vlerësimit si provimi përfundimtar 60 pikë [60%], provimi i ndërmjetëm 20 pikë [20%], ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, ushtrime 10 pikë [10%], detyra/projekte kursi 10 pikë [10%].<br><br>Dijet e studentit kontrollohen nga pedagogu i lëndës me gojë, me shkrim, me detyra kursi ose me shkrime dhe me gojë. E njëjta procedure vlen edhe për provimet, testimet apo seancat e kontrollit gjatë semestrit ose gjatë vitit. Tezat e provimeve përfundimtare sekretohen me barkode, të cilat pas korrigjimit nga pedagogu i lëndës, ç'sekretohen në Departament.<br><br>Gjithashtu, për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmin në vlerësime, sipas RVB, institucioni deklaron se në sallën e provimit janë prezent 2 pedagogë [monitorues] përgjegjës për zbatimin e rregullave të miratura të procesit të provimeve dhe për të siguruar mbarëvajtjen e tyre. Për çdo vendimmarrje vihet në dijeni Departamenti. |

| | |
|---|---|
| monitoruar me personel dhe mjete survejimi.<br><br>**Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.<br><br>**Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.<br><br>**Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.<br><br>**Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.<br><br>**Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Praktikisht, pedagogët monitorues në sallë janë lektori i lëndës dhe asistent lektori i grupit përkatës. Në rast se nuk ka nje asistent lektor, pedagogu i dytë atëherë vendoset një pedagog tjetër me profil lënde të përafërt.<br><br>Sipas RVB, vizitës së kryer dhe informacione të marra rezulton se në provimet me shkrim ruhet anonimiteti përmes sektretimit të provimeve. Pasi korrigjohen provimet nga pedagogu i lëndës, depoyitohen dhe ç'sekretohen në Departament. Studentët informohen mbi vlerësimin përmes sekretarisë mësimore të programit të studimit. Teza e provimit mban vlerësimin dhe firmën e pedagogut ose pedagogove që e kanë korrigjuar<br><br>Gjithashtu, vlerësimi i dijeve të studentëve është i përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" dhe në syllabuset e çdo lënde. Format e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar me barkod personal. Gjithashtu, vehet re se sezoni i provimeve nuk është mënyra e vetme e testimit të dijeve të studentit. Në kuadër të politikës së Universitetit dhe në rregulloren e Universitetit është praktikë që nota përfundimtare të mblidhet nga testet e kryera gjatë semestrit në secilën lëndë, përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve përbën vlerësimin përfundimtar. Studentët informohen nga pedagogët e lëndës në fillim të semestrit për programin e lëndës, skemat e vlerësimit, përmbajtjen e sillabusit dhe formën e kontrollit të njohurive të tyre përgjatë semestrit dhe në fund të tij.<br><br>Vlerësimi i mësimdhënies kryhet nga Departamenti dhe NJSBC nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme. Pedagogët kanë detyrim që të bëjnë vetë-raportimin dhe Departamenti bën një raport semestral [raport tip] në lidhje me cilësinë e mësimdhënies. Në fund të semestrit realizohet anketa e studentëve ku vlerësohet personeli akademik Studentët kanë mundësi të bashkëpunojnë me pedagogët ose në mënyrë individuale në punime shkencore dhe të marrin pjesë në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare që organizon Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Gjithashtu, përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë në mbledhje e departamentit dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Studentët mund të shprehin mendimet e tyre edhe përmes përfaqësuesve të Këshillit Studentor dhe kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik.<br><br>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga pedagogu i lëndës dhe gjatë provimit nuk lejohen materiale që gjykohen të papërshtatshme nga ai. Pedagogu i lëndës në fillim të çdo provimi tregon materialet e lejuara për përdorim gjatë provimit. Temat e diplomave, pas përzgjedhjes nga studenti, në bashkëpunim me udhëheqësin, departamenti bën kontrollin e saj në databazën e departamentit.<br><br>Gjithashtu, korrigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e pedagogut titullar brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit<br><br>Nota mesatare është rezultat i kombinimit të vlerësimeve të provimit të ndërmjetëm, provimit përfundimtar, angazhimit të studentit në orët e seminarëve dhe ushtrimeve, si dhe cilësia e detyrës së kursit nëse parashikohet një e tillë. |

| | |
|---|---|
| | Vlerësimi i pikëve të secilës prej formave u bëhet e ditur studentëve përmes sektretarisë mësimore.<br><br>Nga RVB, vehet re se studenti ka të drejtë për tu njohur me vlerësimin dhe me mënyrën e korrigjimit, për të qenë i qartë për gabimet në përgjigje dhe për vleresimin sipas meritës pasi është bërë ç'sektretimi i saj nga departamenti. Nëse studenti konstaton rubrika të pakorrigjuara apo pikë të papërllogaritura, ai ka të drejtë ta reklamojë me shkresë me shkrim në sekretarinë mësimore deri në 48 orë pas shpalljes së rezultateve<br><br>Dekani, pas reklamimit të kryer nga studenti, ngre një komision ad hoc ku bëjnë pjesë edhe pedagogët që kanë korrigjuar provimin dhe vendimi merret deri në një javë nga data e reklamimit. Vendimi i njoftohet studentit përmes sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet procesverbalit të provimit [fletës së provimit]<br><br>**[Aneksi 1.4 – Rregullore e Albanian University], [Aneksi 1.3 - Rregullore e Departamentit te Shkencave Ekonomike]; [Aneksi H.3 - Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar"]. [Aneksi 3.1 - Format syllabusi 2020-2021]. [Aneksi R.4.a - Raport Vjetor DSHE 2018-2019 dhe Aneksi R.4.b - Raport vjetor DSHE 2019-2020]. [3.2 - Formati raport vetevleresimi i stafit akademik, raport semestral]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.<br><br>**Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit [përfshirë edhe në gjuhë të huaj].<br><br>**Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo | Referuar RVB-së dhe informacionit të siguruar nga takimet me Dekanin, përgjegjësen e Departamentit, studentët dhe stafin akademik, programi i studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në funksion të aplikimit të metodave teorike dhe praktike në lidhje me menaxhimin bankar.<br><br>Objektivat kryesore të programit të studimit i Shkencave në "Menaxhim Bankar" janë:<br><br>- t'u ofrojë studentëve njohuri të avancuara në lëndët e formimit të karakterit shkencor dhe ekspertizë teknike dhe aplikative për formimin e studentëve në sektorin menaxhimit bankar dhe financiar.<br>- Gjithashtu, ai synon që të formojë ekspertë me njohuri dhe kompetenca profesionale të aftë në këtë fushë dhe të aftë të integrohen në institucioneve financiare dhe jo financiare ose specifike të lidhura me fushën për të rritur mundësitë e tyre në tregun e punës. |

| | |
|---|---|
| lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.<br><br>**Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.<br><br>**Kriteri 5.** Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.<br><br>**Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.<br><br>**Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.<br><br>**Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.<br><br>**Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.<br><br>**Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | - Një tjetër synim është të ofrojë një bazë të nevojshme për t'u mundësuar studentëve ndjekjen e cikleve të tjera të studimit si dhe karrierës së ardhshme profesionale. Në këtë mënyrë, ky program synon të pajis studentët me bazat analitike dhe konceptet bazë për të trajtuar problematikat e menaxhimit bankar dhe shprehitë e veçanta të fushës<br><br>Programi i studimit i Shkencave në "Menaxhim Bankar" është program me karakter shkencor dhe profesional dhe i mundëson studentit marrjen e njohurive në fushën e menaxhimit financiar të institucioneve financiare dhe jo financiare ose tregjeve e titujve financiarë.<br><br>Gjithashtu, lëndët e Ekonometri në Financë, Menaxhim i Sistemeve të Informacionit, i jep studentëve informacion në përdorimin e teknologjisë së informacionit me aplikim në financë. Detyrat e kursit zhvillojnë aftësitë komunikuese dhe prezantuese përmes ppt dhe raporte.<br><br>Kompetencat dhe aftësitë studentët i fitojnë përmes detyrave të kursit dhe seancave përmbledhëse ushtrimesh dhe vetëvlerësojnë dijet e tyre para provimit përfundimtar. Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raportin semestral mbi realizimin e objektivave të mësimdhënies<br><br>Bazuar në RVB konstatohet se gjatë orëve të fundit të mësimit studentët dorëzojnë detyrat e kursit apo seancat e ushtrimeve dhe vetëvlerësojnë aftësitë e tyre para provimit përfundimtar.<br><br>Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët dhe nga RVB, stafi akademik gjatë zhvillimit të çdo lënde, ilustron temat e trajtuara me lënde/moduli, personeli akademik dhe shembuj konkretë. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave dhe çeshtjeve më të rëndësishme dhe kryesore, duke vënë theksin në përdorimin e tyre në sektorin e biznesit bankar por jo vetëm. Gjithashtu, DSHE organizon herë pas here leksione të hapura, duke ftuar specialistë të fushave të ndryshme të bankave apo institucioneve mbikqyrëse, për të sjellë gjetjet më të fundit të tyre dhe duke njohur studentët me to.<br><br>Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" është hartuar në kuadër të disa kompetencave që merren nga baza teorike në auditor dhe zhvillohen me praktikën profesionale në semestrin e dytë të vitit të dytë, duke mundësuar zhvillimin e njohurivë të marra në laborator dhe kompetencave në projektim dhe zbatim tek studentët.<br><br>GVJ, konstaton se pedagogët organizojnë leksionet në mënyrë që një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin.<br><br>Gjithashtu studentët inkurajohen në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik që të marrin pjesë në konferenca dhe të publikojnë punimet e tyre në revista të ndryshme. Dhe personeli akademik është i gatshëm të ofrojë udhëzime dhe ndihmë për studentët e tyre duke bashkëpunuar në projekte të ndryshme ose punime konferencash. |

| | |
|---|---|
| | Institucioni Albanian University nxit zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore duke organizuar konferenca, trajnime, leksione të hapura, seminare apo trajnime profesionale, duke inkurajuar mendimin kritik të studentëve dhe duke bërë të mundur përishirjen e tyre në aktivitete të një rëndësie të madhe. Siç u konstatua, Departamenti i Shkencave Ekonomike organizon prej disa vitesh Konferencen shkencore studentore, të dedikuar vetëm për studentët.<br><br>Institucioni ofron mundësi mobiliteti dhe shkëmbimi i eksperiencave me institucionet partnere përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të Departamentit të Shkencave Ekonomike, si pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilat kontribuojnë në rritjen e mobilitetit dhe shkëmbimeve studentore.<br><br>**[Aneksi H.3 - Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar"]. [Aneksi 3.1 - Format syllabusi 2020-2021]. [3.2 - Formati raport vetevleresimi i stafit akademik, raport semestral] [Aneksi 3.4 - Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare 2019-2020].** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.8<br>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.<br><br>**Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.<br><br>**Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të | Bazuar në RVB, vizita në institucion si dhe nga takimi me përgjegjësen e Departamentit, stafin akademik dhe studentët e programit të studimit rezultoi se institucioni ka të detajuar në Rregulloren e programit të studimit procedurën e diplomimit. Diploma Master i Shkencave në Menaxhim Bankar fitohet me anë të mbrojtjes së diplomës.<br><br>Struktura përgjegjëse u vë studentëve në dispozicion një grup të gjërë temash për të punuar tezën e diplomës, por ata janë të lirë gjithashtu të identifikojnë një çështje dhe ta zhvillojnë në autonomi një tezë të caktuar. Struktura përgjegjëse gjithashtu ka krijuar një program 12 Javor [2 orë në javë] ku një pedagog i specializuar orienton studentët në identifikimin e çështjes që do të trajtojë dhe zgjedhjen e pedagogut drejtues. Pedagogu shoqëron studentët e programit Master i Shkencave në Menaxhim Bankar nga përzgjedhja deri në dorëzimin përfundimtar të Temës së diplomës.<br><br>Nuk ka evidence per kriterin 3 mbi komisionin e posaçëm për administrimin e provimit final.<br><br>Orientimi i studentëve është në dy etapa një në formën orientuese përmes një programi 12 javor [2 orë në javë] ku një pedagog i specializuar orienton mbi temat e tezave/ diplomave dhe zgjedhjen e pedagogut udhëheqës. Dhe etapa e dytë është kur udhëheqësi i temës së diplomës që ndjek studentin gjatë gjithë periudhës së |

| | |
|---|---|
| gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.<br><br>**Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.<br><br>**Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës [kur aplikohet] asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.<br><br>**Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.<br><br>**Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.<br><br>**Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.<br><br>**Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | punimit të temës së diplomës Gjithashtu, udhëheqësi i temës së diplomës udhëzon studentin për realizimin me sukses të projektit të diplomës në të gjitha aspektet, si metodologjia e përshtatshme, literaturën mbështetëse, shkrimin e tezës, prezantimin e saj etj.<br><br>Udhëheqësit e temës së diplomës dhe stafi mësimor sigurojnë që studentët të kenë të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e matjeve, analizave dhe për të përgatitur një punim diplome duke organizuar në mënyrë të rregullt takime individuale ose në grup, si dhe duke iu ofruar mjedise dhe literaturë të përshatshme për zhvillimin e temës së studimit. Gjithashtu, Departamenti i Shkencave Ekonomike vë në dispozicion të studentëve mjediset dhe Laboratorin e Informatikës si dhe ambjentet e Institucioneve me të cilat bashkëpunon për realizimin me sukses të projekteve të diplomës.<br><br>GVJ konstaton se udhëheqësi i temës së diplomës ka detyrimin për të ndjekur studentin gjatë gjithë periudhës së punimit të temës së diplomës. Ai e udhëzon studentin për realizimin me sukses të projektit të diplomës mbi shkrimin e temës sipas metodologjisë së përshtatshme për t'u përdorur, literaturës mbështetëse, shkrimin e tezës, prezantimin e saj etj. Në përfundim të temës së diplomës, para dorëzimit në departament udhëheqësi harton një vlerësim, i cili i vihet në dispozicion komisionit përfundimtar të vlerësimit, krahas kontrolleve të zhvilluara nga Departamenti mbi avancimin e punës nga ana e studentit.<br><br>Referuar rregullores së programit të studimit**,** rezulton se Komisioni i mbrojtjes së temave të diplomave në përfundim të prezantimit të temave, diskutojnë dhe japin vlerësimin përfundimtar me notë për studentin diplomant. Vlerësimi pasqyrohet në procesverbalin e diplomimit, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të diplomimit.<br><br>Siç është e parashikuar në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar", bazuar të ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në përfundim të studimeve në programin Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" dhe me shlyerjen e detyrimeve akademike, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas modelit të aprovuar nga Ministria.<br><br>Në përfundim të studimeve studenti merr diplomën së bashku me suplementin. Institucioni, me kërkesë të studentit, i ve në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit dhe të syllabusit të lëndëve të zhvilluara, të firmosura nga titullari i institucionit.<br><br>Gjithashtu se sekretaria mësimore ruan në arkivat e saj të gjithë dokumentacionin e studentëve të diplomuar dhe studenti ka akses për ta kërkuar atë në çdo kohë. Të dhënat e studentëve të diplomuar ruhen dhe azhornohen periodikisht, në veçanti lidhur me vijueshmërinë e punësimit të tyre pas diplomimit. Zyra e Karrierës dhe Alumnive disponon të dhëna për studentët e diplomuar.<br><br>**[Aneksi H.3 - Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar", Neni 33, fq. 18]. [Aneksi 3.9 - Lista e pedagogëve udhëheqës**]. **[Aneksi 3.10 - Formati i** |

| | |
|---|---|
| | **vlerësimit të temës së diplomës]. [Aneksi I.27; Aneksi I.21] [Aneksi E.2 - Diploma – Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar", Aneksi E.3 - Lista e notave - Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" dhe Aneksi E.4 - Suplement - Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar"].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Bazuar në RVB, takimin me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Ekonomike disponon dhe përditëson në fillim të vitit akademik çdo të dhënë apo dokumentacion lidhur me personelin akademik dhe atë administrativ.<br><br>Institucioni ruan çdo informacion lidhur me stafin akademik, personelin ndihmës, personelit mësimor-shkencor dhe administrativ.<br><br>Referuar RVB, AU garanton transparencën ndaj publikut, paanshmërinë, shanse të barabarta të konkurimit dhe zbatim rigoroz të kritereve ligjore te parashikuara ne Ligjin e Arsimit te Larte 80/2015, Neni 64, Pika [1] dhe Kodit te Punës. Kriteret e përgjithshme parashikohen nga Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.<br><br>Departamenti i Shkencave Ekonomike në përputhje me Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat për personel akademik, i paraqet Dekanit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante.<br><br>Vlerësimi i kandidatëve bëhet përmes Komisionit të Vlerësimit, pjesë e të cilit janë përfaqësues të njësisë bazë dhe kryesore. Duke filluar nga viti akademik 2017 - 2018, me vendim të Senatit Akademik**,** nisur nga nevojat e departamenteve për |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | personel akademik procedurat e rekrutimit hapen edhe para fillimit të semestrit të dytë<br><br>Gjithashtu në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat e tyre për personel akademik Njësitë Bazë të Fakultetit përkatës i paraqesin Dekanatit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Dekanati i Fakultetit ja përcjell kërkesat Rektoratit, i cili përcakton kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit.<br><br>Nga kontrolli i faqes ueb të AU u evidentua se institucioni publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për pdo vend vakant në faqen ueb zyrtare **[https://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-viti-akademik-2020-2021-semestri-i-dyte]** si dhe në mjete të tjera komunikimi publik.<br><br>Bazuar në RVB, vizita në institucion si dhe nga takimi me Dekanin, përgjegjësen e Departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit vehet re se institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit të përshtashëm për personelin. Rezulton se universiteti përcakton kriteret e përgjithshme që kandidatët konkurues duhet të përmbushin, siç janë a. diplomimi përkatës dhe i përshtatshëm për vendin e punës së kërkuar, b. formimi i përgjithshëm arsimor dhe profesional, c. kualifikimi [gradat shkencore ose titujt akademikë] dhe rezultatet e kërkimit shkencor brenda dhe jashtë vendit, d. përvoja pedagogjike dhe eksperienca të mëparshme në universitet, e. zotërimi i aftësive të nevojshme personale për vendin e punës.<br><br>Në bazë të RVB dhe dokumentacionit të ngarkuar evidentohet se komisioni i vlerësimit pasi shqyrton kandidaturat i propozon Dekanit për miratim kandidatët e përzgjedhur, sipas një renditje të kandidatëve që plotësojnë më mirë kriteret dhe i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës<br><br>**[Aneksi 1.6 - Rregullore e FSHAE, neni 19, pika 4 - 5, fq. 12 dhe Aneksi Aneksi R.1.d - Rekrutimi i stafit akademik, 2020-2021 S.I.]. [R.1.b - Rekrutimi i stafit akademik, S.II 2018 - 2019]. [Aksesi 4.1 - R.2 VS Nr. 24, Nr. 901.3 Prot., dt. 13 12 2017]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të | Bazuar në RVB, vizita në institucion si dhe nga takimi me Dekanin, përgjegjësen e Departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit konstatohet se AU ka vënë në dispozicion të stafit akademik dhe atij administrativ ambjente të |

| | |
|---|---|
| personelit në mënyrë profesionale.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | dedikuara, si dhe instrumentat e nevojshëm [kompjutera, kancelari etj.] për të mundësuar mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore dhe administrative<br><br>Gjithashtu, AU ofron lehtësira dhe hapësira për personelin akademik të interesuar në zhvillimin e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit, mbështet dhe nxit ata në këtë drejtim. Gjithashtu organizon vazhdimisht trajnime për stafin akademik me qëllim zhvillimin personal dhe profesional të tij.<br><br>Bazuar në RVB dhe nga komunikimet me organet drejtuese të AU u lajmëruam se “Albanian University” së shpejti do të aplikojë për hapjen pranë Departamentit të Shkencave Ekonomike të programit të ciklit të tretë Doktoratë në “Ekonomi dhe Zhvillim i Qëndrueshëm” për të mundësuar avancimin e mëtejshëm akademik të stafit efektiv por edhe për të plotësuar misionin e tij si Universitet për ofrimin e të gjithë cikleve të studimit.<br><br>Nga vizita në institucion GVJ konstaton gjithashtu, se trajnimet e stafit akademik përbëjnë një pjesë integrale të Planit të Zhvillimit Strategjik të “Albanian University”. Evidentohet se NJSBC në bashkëpunim me njësitë e tjera të institucionit organizon trjanime të stafit me fokus specifik, për të përmirësuar zhvillimin profesional. Trajnimet zhvillohen nga trajnues vendas dhe të huaj me qëllim ndërkombëtarizimin e AU.<br><br>Gjithashtu, DSHE ka në fokus metodat inovative në mësimdhënie, veçanërisht ato në aplikimin e analizës matematikore në menaxhimin financiar në funksion të mësimdhënies. Në vitin 2017 janë organizuar aktivitete shkencore dhe janë bërë disa aplikime në projekte ndërkombëtare në këtë kuadër. Gjithësesi, vehet re një tkurrje e aktiviteteve innovative në vitet e mëpasshme.<br><br>Gjithashtu, stafi i Departamentit të Shkencave Ekonomike në bashkëpunim me NJSBC ka organizuar një trajnim në nivel Universiteti për nxitjen e përdorimit të platformës Google Classroom**.**<br><br>Stafi akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar” kanë të paktën gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, në bazë të kritereve ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe përvojën disa vjeçare në fushën ku janë angazhuar.<br><br>**[RVB Tabela 16**]. **[Aneksi 4.2 Informacion mbi kontaktet e krijuara me Universitete [Shtator 2018-Janar 2019]]. [Aneksi 3.5.b - Axhenda e trajnimeve te stafit akademik 2019-2020].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.<br><br>**Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.<br><br>**Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | Referuar RVB-së, vizitës në institucion GVJ konstatoi se institucioni AU disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar”<br><br>GVJ evidentoi që Departamenti i Shkencave Ekonomike zhvillon aktivitetin në godinën qëndrore të universitetit në Bulevardin Zogu i Parë. Në shërbim të programeve të studimit Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional të ofruara prej tij është vënë në dispozicion një ndërtesë e madhe, e rikonstruktuar në të gjitha ambientet e saj, e mësimdhënëse teorike, në varësi të përshtatur për universitetin me salla leksionesh, seminaresh dhe laboratorë të cilat janë të pajisura me kompjuter, videoprojektor, ekrane të mëdha, flipcharte, mësimore, në përputhje me natyrën multimedia, me mjetet e nevojshme teknologjike për të zhvilluar një edukim cilësor.<br><br>Të gjitha sallat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme imobiliare dhe me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor etj. në funksion të mbarëvajtjes së mësimdhënies. E gjithë godina mbulohet nga rrjet interneti wireless, e disponueshme për të gjithë.<br><br>Gjithashtu, në funksion të programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, AU ka vënë në dispozicion laboratorin e informatikës, laboratorët, nën kujdesin e stafit përgjegjës, janë të disponueshme për studentët gjatë orëve të mësimit për përgatitjen e detyrave të kursit, diplomimeve apo studimeve të tjera nga ana e tyre, si punimet për pjesëmarrje në Konferencat Studentore.<br><br>**[Aneksi 4.3 - Planimetrite]. [RVB Tabela 5]**<br><br>**[Aneksi 4.3 – Planimetrite, Tabela 16].** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.<br><br>**Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.<br><br>**Kriteri 5**. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.<br><br>**Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Duke iu referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" realizohet në godinën qëndrore të AU. Kjo godinë ka një bibliotekë me disa tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj (edhe në disa kopje në disa raste). Është evidentuar që studentët kanë hapur kartelat dhe janë regjistruar pranë bibliotekës.<br><br>GVJ konstatoi se Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është vënë në dispozicion të studentëve me 246 tituj librash në fushat ekonomike. Në bibliotekë gjendet mbi 80% e literaturës në gjuhën shqipe, e detyruar në syllabuset e lëndëve. Këto libra gjenden në kopje të mjaftueshme dhe në edicionet e tyre më të fundit. Literatura e ofruar si në formë hardcopy, në format elektronik dhe online mundësojnë realizimin me sukses të projekteve kërkimore-shkencore të moduleve e veprimtarive mësimore të kërkuara nga pedagogët në kuadër të mësimdhënies dhe në përgatitjen e tezës së diplomës.<br><br>AU ka vënë dispozicion të studentëve një sërë librarish online të cilat janë të aksesueshme nën kujdesin e punonjëses së bibliotekës në qendrën e internetit<br><br>Gjithashtu, u evidentua që biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të cilat u vijnë në ndihmë studentëve për të aksesuar në bibliotekat online që AU disponon.<br><br>AU çdo vit planifikon fond të veçantë për blerjen e literaturtës së detyrueshme për çdo program studimi dhe në mbështetje të kërkimit shkencor. Çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimet e syllabuseve, departamenti bën kërkesat e tij për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër.<br><br>Gjithashtu, Biblioteka e Fakultetit është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte 8.00 — 16.00, dhe ditën e shtunë 8.00 — 12.00. Këto orare janë të shpallura në mjediset e fakultetit.<br><br>Studentët kanë kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës. Shërbimi i bibliotekës realizohet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga institucioni dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët, të cilët regjistrohen përmes kartës së regjistrimit dhe mund të aksesojnë literaturë si në gjuhën shqipe dhe ato në gjuhë të huaj në ambientet e bibliotekës. Salla e bibliotekës disponon një numër tavolinash dhe kënd leximi, me një hapësirë që plotëson kërkesat e studentëve. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **[Aksesi 2.4 - Literatura e disponueshme në bibliotekën e FSHAE për DSHE.pdf]. [RVB Tabela 17]. [Aneksi R.3 - Kërkesë për pasurimin e bibliotekës 2020-2021]** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.<br><br>**Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.<br><br>**Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.<br><br>**Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion pranë sekretarisë mësimore, GVJ konstaton se Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe azhornimin periodik të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim.<br><br>Albanian University disponon sekretarinë online [Linku në RVB nuk është funksional]. Studentët kanë llogarinë e tyre, ku mund të logohen me kredencialet personale dhe të marrë informacionin personal në lidhje me të dhënat e tij të përditësuara, rezultatet e arritura, lëndët të cilat duhet të frekuentojë etj.<br><br>Gjithashtu, informacionet që lidhen me aktivitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik ruhen në Departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Nga kontrolli i disa dosjeve, u konstatua se kishte mungesë informacioni mbi të dhënat.<br><br>Informacionet lidhur me partnerët e angazhuar në realizimin e programit ruhen në Departament dhe në zyrat përkatëse: Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e koordinimit të Kërkimit dhe Botimeve Akademike etj. në funksion të fushës së bashkëpunimit.<br><br>Dokumentacioni i stafit akademik dhe i studentëve është lehtësisht i aksesueshëm nga sistemi i brendshëm i institucionit.<br><br>Gjithashtu, stafit akademik, atij administrativ dhe studentëve i është vënë në dispozioni email zyrtar institucional, bashkë me paketën Office 365. Aplikacionet e kësaj pakete mundësojnë ruajtjen dhe shpërndarjen e informacioneve si dhe komunikimin interaktiv në kohë reale ndërmjet përdoruesve.<br><br>Aktivitetet akademike dhe administrative janë të publikuara në faqen zyrtare të AU [www.albanianuniversity.edu.al] dhe të aksesueshme nga të gjithë përdoruesit sipas roleve të tyre dhe njësisë përkatëse. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Gjithashtu, në faqen zyrtare të AU [www.albanianuniversity.edu.al] jepen informacione lidhur me programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, aktivitetet e ndryshme të zhvilluara nga institucioni, të cilat janë në azhornim të vazhdueshëm etj.. Faqja ëeb është e ndërtuar në dy gjuhë shqip dhe anglisht.<br><br>**[Aneksi 4.4 - Rregullore e sekretarisë mesimore]** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.<br><br>**Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të | Bazuar në RVB, vehet re se si institucion universitar privat AU, funksionon në bazë të parimit të autonomisë financiare [sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, 80/2015]. "Albanian University", si pjesë e Shoqërisë UFO shpk, i akordohet një buxhet vjetor në përputhje me nevojat, bazuar në programin financiar afatmesëm tre vjeçar. Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm hartohen në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar, rregullave të kërkuara në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin Nr. 9901, date 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në Ligjin Nr. 9228, date 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", akteve të tjera nënligjore në zbatimin e tyre, akteve normative të AU, si dhe Strategjisë së Zhvillimit Institucional të tij.<br><br>Procesi i hartimit të programit financiar fillon në muajin shtator dhe miratohet në organet përkatëse brenda muajit dhjetor të vitit paraardhës financiar.<br><br>Para fillimit të vitit të ri akademik, Bordi i Administrimit vendos kriteret mbi të cilat do të hartohet projektbuxheti vjetor dhe rregullat për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij dhe ja përcjell organeve drejtuese akademike dhe administrative.<br><br>Bazuar në këtë kritere, Administratori i Përgjithshëm i AU, i cili është edhe anëtar i Rektoratit, në bashkëpunim me Zyrën e Financës dhe administratorët e njësive kryesore, mbështetur në nevojat e paraqitura nga njësitë bazë dhe kryesore, harton projektbuxhetin vjetor dhe atë afatmesëm tre vjeçar.<br><br>Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm tre vjeçar, pasi diskutohen në Rektorat kalon në Senatin Akademik. Senati akademik e miraton paraprakisht dhe ia përcjellë për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit. |

| | |
|---|---|
| të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.<br><br>**Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Bazuar në RVB shikohet se struktura e programit financiar bëhet duke i ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet sipas drejtimeve, në të cilin ato do të përdoren.<br><br>Për sa i përket raporteve që zënë shpenzimet për veprimtarinë mësimore dhe shkencore, ato janë kryesisht të veprimtarimeve mësimore të AU dhe përfshijnë pagat dhe kontributet, shpenzime për kërkimin shkencor dhe fondin e ekselencës, shpenzime të përgjithshme operative etj.<br><br>Të gjitha zërat e mësipërme bëhen bazuar në nevojat e njësive bazë dhe kryesore, përfshirë gjithashtu planin e investimit dhe mbikqyr zbatimin e tyre, ku përfshihen financimet për burimet njerëzore në shërbim të programit të studimit, kërkesat për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të kërkuara, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, si p.sh. Investimet në laboratorin e informatikës, shpenzime për pasurimin e literatures dhe bibliotekave online dhe të gjithë zërave të tjerë të njësisë bazë.<br><br>Sipas RVB, në AU është ngritur dhe funksionon si njësi administrative Zyra e Auditit të Brendshëm. Zyra e Auditit të Brendshëm, si pjesë integrale e kontrollit të brendshëm dhe njësi e specializuar e saj, ka për mision kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funsionimit të Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm. Institucioni kryen edhe audit të përvitshëm për situatën financiare nga një kontabël i miratuar dhe i registruar, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik, raportet e të cilëve ndërtohen sipas standardeve përkatëse. Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. Raportet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm analizojnë eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe përdorimin e tyre për të bërë të mundur rritjen e cilësisë së studimeve për të gjitha ciklet. Ato raportohen në mënyrë periodike pranë Bordit të Administrimit.<br><br>Institucioni ka të dokumentuara raportet financiare për të tri vitet e fundit, procedurat e të cilave fillojnë të kryhen gjatë periudhës mars-maj. Rektorati përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit. Në përfundim të kësaj faze realizohet edhe një analizë që planifikon ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen për mbarëvajtjen e programeve të studimit.<br><br>Sipas RVB, situata financiare dhe bankare dëshmon se AU ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësim të mëtejshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.<br><br>Sidoqoftë, përveç RVB nuk ka dokumenta që evidentojnë situatën financiare, raportet financiare dhe planin e financimit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.<br><br>**Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.<br><br>**Kriteri 5.** Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vlerëson se në përcaktimin e kritereve pranuese të AU në programin Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar", institucioni ndjek të njëjtat politika dhe praktika si edhe për programet e tjera të studimit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Pranimi në ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi, mbi rregulloren e programit dhe rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve. Kandidati për ndjekjen e programit Master i Shkencave në Menaxhim Bankar paraqitet personalisht pranë sekretarisë mësimore, ku plotëson formularin e aplikimit për këtë program si dhe paraqet dokumentacionin përkatës. Procesi i seleksionimit organizohet dhe drejtohet sipas rregullores së organizimit të programit, rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve dhe sipas vendimeve të autoriteteve drejtuese.<br><br>GVJ konstaton se në Rregulloren mësimore të Programit të Studimit jepen informacione mbi kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. Në Rregulloren e Regjistrimeve dhe të Transferimeve jepen informacione të detajuara për njohjen e plotë ose të pjesshme të studimeve të mëparshme. Të gjitha këto informacione vihen në dispozicion të studentëve nga strukturat përkatëse, të cilat janë të disponueshme edhe për sqarime të mëtejshme. |

| | |
|---|---|
| nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.<br><br>**Kriteri 6.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Në RVB shënohet se kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit Master i Shkencave të ofruara nga Departamenti i Shkencave Ekonomike janë:<br>1. Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor apo të sistemit të vjetër [minimumi 3 vite];<br>2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë si Diploma e ciklit të parë të jetë e përputhshme në masën 70 % me programin e studimit të Masterit të Shkencave në Menaxhim Bankar;<br>3. Aftësitë e njohjes së njërës prej pesë gjuhëve europiane me anë të një prej testeve ndërkombëtarisht të njohura nga MASR;<br>4. Një letër interesi ku paraqiten interesat kërkimore dhe profesionale për kryerjen e programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Bankar.<br><br>Por në Rregulloren e Masterit të Shkencave në Menaxhim Bankar [*Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar", Kreu 3, neni 10, fq.8-9*] janë këto pika por mungon: **përcaktimi mbi gjuhën e huaj** [sipas MASR] dhe letra e interesit [edhe pse kjo e fundit nuk është domosdoshmëri]. Sugjerohet që kjo e fundit të specifikohet më qartë në rregullore.<br><br>Në rast se studenti ka përfunduar një diplomë tjetër jashtë disiplinës së përcaktuar më lart, atëherë një komision i veçantë i ngritur nga Fakultetit i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike vlerëson aplikimin duke marrë në konsiderate këto kritere: 1. Diploma e ciklit të parë të jetë e përputhshme në masën 70 % me programin e studimit të Masterit të Shkencave në Menaxhim Bankar; 2. Dosjen e kandidatit; 3. Motivimin e tij për të ndjekur programin e caktuar.<br><br>Në RVB shënohet se aplikimi kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor apo të sistemit të vjetër [minimumi 3 vite] dhe janë të pajisur me: a. dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor; b. nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në IAL-të publike ose jopublike; c. plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për programin e studimit për të cilin aplikojnë.<br><br>Por në Rregulloren e Masterit të Shkencave në Menaxhim Bankar **[Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar", Kreu 3, neni 10, fq.8-9**] shënohet se pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" në AU është me dosje. Dokumentet që kandidati/ja paraqet në dosje përcaktohen paraprakisht nga komisionet përkatëse të pranimit që ngrihen për çdo Njësi Bazë dhe miratohen nga Senati i Universitetit, në përputhje me kriteret e vendosura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. |

| | |
|---|---|
| | Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundëshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.<br>Për keto programe dokumentet e aplikimit janë:<br>1. Formulari i aplikimit;<br>2. Kopje e noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve, ose e një diplome tjetër studimi e fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të nga struktura përkatëse në MASR;<br>3. Lista e notave e noterizuar;<br>4. CV-në e kandidatit ku paraqiten të dhëna bibliografike të kandidatit;<br>5. Dokument identifikimi [lartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë];<br>6. (2) fotografi të formatit të pasaportës;<br>7. Shtetasit e huaj duhet të paraqesin edhe lejën e qëndrimit në Shqipëri [kopje e noterizuar];<br>8. Paraqitja e një dokumenti që vërteton aftësitë e njohjes së njërës prej pesë gjuhëve evropiane me anë të një prej testeve ndërkombëtarisht të njohura nga MASR.<br>9. Një letër interesi ku paraqiten interesat kërkimore dhe profesional për kryerjen e programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar”.<br>**[Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”, Kreu 3, neni 10, fq. 8-9], [Aneksi 2.3 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve, neni 6, fq. 3], [Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”, Neni 25, fq. 15-16], [Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”, Kreu V, fq. 18 – 19]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **x** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se Institucioni që në regjistrim informon studentët me përmbajtjen e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse, me vëmendje të veçantë në procedurat e përparimit të tyre akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin: |

<table>
<tr>
<td>studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.<br><br>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.<br><br>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.<br><br>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.<br><br>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</td>
<td colspan="4">a. Studenti, i cili në përfundim të vitit akademik nuk merr 50% të krediteve [së bashku me sesionin e vjeshtës], nuk kalon në vitin akademik pasardhës, por mbetet në stazh.<br>b. Studenti detyrohet të frekuentojë lëndët e të rifutet në sesionet përkatëse të provimit.<br>c. Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës [ose provim formimi], nëse ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura të programit mësimor.<br><br>Institucioni që informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme është Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve përgjegjëse për realizimin e regjistrimeve dhe transferimeve të studimeve, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin, informon studentët e interesuar me procedurat përkatëse për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve.<br><br>Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët [ZKMS] janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj.. Gjithashtu, gjatë orëve të para të mësimit, gjithashtu, pedagogët njohin studentët me përmbajtjen e syllabusit të lëndës, në të cilën përfshihen edhe format e vlerësimit konkret për secilën lëndë. Brenda semestrit të parë të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, mbi hapat që do të ndjekin për punimin e temës së diplomës me anë të së cilës do të bëhet edhe vlerësimi përfundimtar dhe përmbyllja e detyrimeve akademike në programin master i shkencave.<br><br>Gjithashtu, institucioni nëpëmjet zyrës përkatëse por edhe instancat e tjera specifikisht Departamenti, informojnë kandidatët e interesuar për programet e studimit Master, duke ju dhënë të gjithë informacionin mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to, stafin akademik të angazhuar në secilin program studimi, detyrimet akademike për studentin e deri në finalizimin e studimeve master.<br><br>[Aneksi H. 3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”, Neni 28. fq. 17], [Aneksi 2.3 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve, Neni 3, fq. 2]; [Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në “Menaxhim Bankar”, Neni 25, fq. 15 dhe Aneksi 3.1 Format syllabusi 2020-2021], [Aneksi 5.1 Kërkesë për Temë Diplome e Studentit]</td>
</tr>
<tr>
<td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td>
<td>Nuk përmbushet</td>
<td>Përmbushet pjesërisht</td>
<td>Përmbushet kryesisht</td>
<td>Përmbushet plotësisht</td>
</tr>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td>X</td>
</tr>
</table>

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.<br><br>**Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.<br><br>**Kriteri 5** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. | Bazuar në RVB, vizitës në institucion, GVJ vlerëson se studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët [ZKMS] janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj. Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve, me organizimin e lëndës në leksione/ seminare/ ushtrime/ detyra kursi, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar.<br><br>Konstatohet se Institucioni përmes Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët [ZKMS] dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit [ZKA] informon vazhdimisht studentët mbi mundësitë e punësimit, organizon aktivitete të ndryshme orientuese, argëtuese dhe këshilluese mbështet studentët në aplikimet e tyre, mundëson aplikime për punësim në kompani të ndryshme, me të cilat Institucioni bashkëpunon etj. Gjithashtu, GVJ konstaton se Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve në ambjentet e Universitetit, në sekretarinë online dhe në faqen e tij ëeb të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.<br><br>Në fillim të vitit akademik ZKMS në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Ekonomike organizon javën e parë mësimore orë të hapura ku studentët njihen me liçencimin e programit të studimit, akreditimin e tij dhe kurrikulën mësimore që studentët do të zhvillojnë gjatë ciklit të tyre të studimit. ZKMS ka vënë në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese për t'i orientuar ata për të njohur organizimin e institucionit si dhe të drejtat e tyre nëpërmjet Manualit të Studentit Më konkretisht studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme në distancë nëpërmjet:<br><br>1. faqes zyrtare të Albanian University [www.albanianuniversity.edu.al];<br><br>2. Komunikimi në vijimësi në nivel departamenti;<br><br>3. Njoftimi përmes adresave të emailit; Njoftime nëpërmjet rrjeteve sociale.<br><br>Sekretaria mësimore në bashkëpunim me Administratorin e Përgjithshëm administron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin për aktivitetin mësimor të studentëve<br><br>**[Aneksi 3.1 Format syllabusi 2020-2021]. [5.1 Rregullore per Mbrojtjen e Temave te Diplomave]**, **[Aneksi 5.3 Rregullore e ZKA], [Aneksi 5.4.a** |

| | |
|---|---|
| | **Informacion mbi zhvillimin e aktivitetit Yoga per studentet, [Aneksi 5.4.b Informacion mbi krijimin e Klubit Sportiv te Shahut], [Aneksi 5.4.c Perfshirje ne Kampionatin Kombetar Universitar 2019 – 2020 dhe Aneksi 5.4.d Informacion mbi mundësinë e punësimit pranë Noa Holding]; [RVB Tabela 5]; [Aneksi 5.2 Rregullore e ZKMS]. [Aneksi 4.4 Rregullore e sekretarise mesimore].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Instituconi disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.<br><br>**Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konkludon se institucioni disponon të dhëna sipas viteve për studentët që kanë aplikuar, numrin e studentëve që vazhdojnë studimet dhe studentëve të diplomuar në programe. Sekretaria mësimore e programit të studimit, kryesekretaria e Fakultetit si dhe Administratori i përgjithshëm menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databazën e sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave. U evidentua se sekretaria mësimore disponon statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar ndër vite. Gjatë vitit akademik 2018-2019, në programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar" janë diplomuar 8 studentë dhe gjatë vitit akademik 2019-2020 janë diplomuar 22 studentë. Institucioni disponon të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të larguar nga programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe të dhëna mbi ecurinë e studimeve të tyre, që nga pranimi deri në diplomim<br><br>Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët në vite, si studente te regjistruar per here te pare, ashtu edhe ata te tranferuar nga universitete të tjera. Në regjistër hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. |

| **Numri i studentëve të regjistruar** | Per here të parë | Studentë të transferuar | Nota mesatare | Studentë të diplomuar |
|---|---|---|---|---|
| 2018 -2019 | 27 | 1 | 7.16 | 8 |
| 2019-2020 | 21 | 2 | 6.96 | 22 |
| 2020-2021 | 12 | 3 | ?? | |

| | |
|---|---|
| dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Në "AU" është sekretaria mësimore, kryesekretaria e fakultetit si dhe administratori i përgjithshëm të cilët arkivojnë dhe ruajnë dokumentat e çdo studenti që është i regjistruar, është i çregjistruar si dhe të studentëve diplomantë.<br><br>GVJ konstaton se Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me studentët. Sistemi i menaxhimit të tyre është i sigurtë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar. Në çdo moment studentët mund të aplikojnë pranë sekretarisë mësimore për vërtetim notash.<br><br>Gjithashtu, GVJ konstaton se Institucioni në mënyrë periodike harton raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe shkallën e punësimit të studentëve. Në rastet kur vihen re problematika lidhur me këto tregues, ndërmerren masa për përmirësimin e tyre. Këto të dhëna i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsim me kërkesë të saj.<br><br>**[RVB Tabela 23]. [Aneksi 4.4 Rregullore e sekretarise mesimore, Nenet 2, 3 dhe 4. fq 2-4].** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.<br><br>**Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të | Bazuar në RVB, vizitën në institucion dhe takimet me studentët, GVJ vlerëson se studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të AU sipas rregullave ligjore në fuqi. Ata janë anëtarë me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Përfaqësuesit e studentëve janë prezent në mbledhjet e departamentit dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Ata, gjithashtu, shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik**.**<br><br>GVJ konstaton se Institucioni, gjatë hartimit të programeve të reja të studimit dhe rishikimit të programeve ekzistuese, kujdeset në plotësimin e standardeve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse mbi ngarkesën akademike të studentëve në auditor.<br><br>Gjithashtu, Institucioni kujdeset që procedurat e përparimit të studentëve përgjatë programit të studimit të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të realizueshme për ta. Në çdo rast, stafi i zyrave përkatëse është në dispozicion |

| | |
|---|---|
| studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.<br><br>**Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | dhe në mbështetje të studentëve për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që mund të dalin gjatë studimeve të tyre.<br><br>Sipas RVB, nenit 25 të Statutit të "Albanian University", "Komisionet e përhershme", studentët kanë përfaqësimin e tyre në për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional dhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. Në këtë mënyrë me anë të mendimeve dhe sugjerimeve të tyre, ata bëhen pjesë e vendimarrjeve në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Institucioni në vazhdimësi është i hapur dhe me vëmendje të veçantë përpropozimet e studentëve.<br><br>GVJ konstaton se studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve**.** Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura më lart, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision ad hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korrigjuar provimet.<br><br>Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të provimit [fletës së provimit]<br><br>**[Ligji i arsimit të lartë, 80/2015], [Aneksi 1.4 Rregullore Albanian University, Neni 4, pika fq. 4]; [Aneksi 1.4 Rregullore Albanian University]. [RVB Tabela 13], [Aneksi 3.6 Mbledhje departamenti] [Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar", Neni 24, fq. 15]. [Aneksi H.3 Rregullore mësimore MSc në "Menaxhim Bankar", Neni 24, fq. 15]** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me | Bazuar në RVB, vizitën në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se politika e Departamentit të Shkencave Ekonomike në fushën e studimit dhe kërkimit shkencor është e shumëanëshme, në funksion të politikës tërësore të universitetit dhe të zhvillimit ekonomik e |

| | |
|---|---|
| parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.<br><br>**Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | shoqëror të vendit. Veprimtaria kërkimore — shkencore e AU priret, organizohet e zhvillohet në zbatim me ligjin nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Ajo përqendrohet kryesisht në: hartimin e strategjisë së kërkimit shkencor që miratohet nga Senati i AU; në realizimin e kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave specifikë të institucionit; në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e tij; në procesin akademik me programe, teori dhe praktika sipas Kartës së Bolonjës, duke krijuar një raport të drejtpeshuar dhe efektiv ndërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor; në krijimin e shprehive dhe të metodave kërkimore shkencore me studentët, duke i aktivizuar ata deri edhe në përfshirjen e tyre në grupet studimore e projekte që kanë departamentet, fakultetet ose universiteti. AU ka një pozicion të dedikuar për kërkimin shkencor, Zv/Rektorin për Kërkimin Shkencor, i cili synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor Universiteti, për të realizuar botimet akademike në gjuhën shqipe të autorëve akademikë vendas apo të huaj, ka në funksionim Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike si dhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimet. Një periodik tashmë i njohur në rajon është dhe revista "OPTIME". Përfshirja e pedagogëve në projekte të kërkimit shkencor ka qenë individuale në kuadër të projekteve të tyre të doktoraturës ose kërkimin e tyre shkencor. Kërkimi shkencor është fokusuar në punët individuale të pedagogëve në këto drejtime kryesore:<br><br>1. Kualifikimin e pedagogëve të brendshëm për marrjen e gradës Dr. në shkencat ekonomike;<br>2. Përgatitjen e teksteve bazë për të siguruar cilësi më të lartë;<br>3. Studime dhe botime në revista shkencore brenda e jashtë vendit;<br>4. Pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.<br><br>Çdo vit njësia kryesore organizon Konferencën Ndërkombëtare me temë "Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare drejt Standardeve të Bashkimit Europian" në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, Universitetin Bujqësor dhe Universitetin La Sapienza, Romë dhe Konferencën Studentore me AMF Departamenti realizon gjatë viti akademik aktivitete të shumta ekstrakurrikulare me tema dhe të ftuar në shërbim të profileve të programeve që implementon**.**<br><br>Departamenti gjatë viteve akademike 2018-2020 ka realizuar aplikime në 4 projekte: 1. Spreading Excellence and Widening Participation — part of H2020; 2. H2020-MSCA-NIGHT-2018; 3. Intemational open innovation center applying Triple Helix. Model: Academia, Government, and Industry; 4. EACEA Programme "Europe for Citizens": Demoratic engagement and Civic participation. |

| | |
|---|---|
| | Institucioni është pjesë e projektit “GRADUA” [Erarmus+ CBHE] ku nga departamenti i Shkencave Ekonomike janë të përfshirë dy pedagogë [Aneksi 10.6]. GRADUA ka filluar të implementohet në muajin tetor 2017 dhe do të vazhdojë deri në muajin tetor të vitit 2020.<br><br>Personeli akademik angazhon studentët të marrin pjesë në aktivitete ekstrakurrikulare si konferenca studentore apo publikimi i punimit në revistën e Universitetit “OPTIME”.<br><br>Stafi mbështet studentët duke ju vënë në dispozicion edhe literaturën e nevojshme për përfundimin e punimit.<br><br>Pedagogët kanë kryer kërkime të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vet institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit AU publikon revistën periodike “Optime’, e cila përmban artikuj shkencorë të pedagogëve të institucionit, por edhe artikuj të studiuesve jashtë AU. Shumë nga pedagogët e AU janë autorë tekstesh shkollore universitare, për shkollat e mesme dhe ato metodike mësimore në fusha të ndryshme të arsimit. Personeli i ri akademik është në proces kualifikimi të vazhdueshëm e në këtë kuadër ndihmon me publikimet apo kërkimet individuale. Personeli Akademik paraqet në mënyrë periodike [1 herë në vit] arritjet dhe angazhimet akademike sipas një formulari të plotësuar Çdo pedagog udhëheqës për punimin e temës së diplomës orienton studentin tek literatura më bashkëkohore dhe e ndihmon atë të identifikojë trendet më inovative të zgjidhjes së problemeve ekonomike. Nëse studenti ka prirje për zgjidhje specifike, pedagogu drejtues nuk heziton të ndihmojë edhe me orientimin drejt institucioneve që regjistrojnë dhe mbrojnë të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale.<br><br>**[Aneksi 1.4 Rregullore Albanian University, neni 8, fq.10-11]; [Aneksi R.4.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019 dhe Aneksi R.4.b Raport vjetor DSHE 2019-2020]. [Aneksi 5.5 Aktivitet shkencor, Konferenca Dhjetor 2018]; [Aneksi 3.3 Formulari i vlerësimit të stafit akademik PAE-PAK]; [Aneksi 1.4 Rregullore Albanian University, neni 17-18, fq.19-20]; [Aneksi 2.8 Revista Optime]; [Aneksi 1.8 Marrëveshje me AMF].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.7**<br>**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen | Bazuar në RVB, vizitën në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë. Pedagogë të DSHE si dhe Drejtuesi |

| | |
|---|---|
| e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.<br><br>**Kriteri 2.** Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.<br><br>**Kriteri 4.** Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.<br><br>**Kriteri 6.** Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore | Departamentit kanë marrë pjesë në disa takime të organizuara nga Agjencia për Kërkim Shkencor, zyra e Erasmus në Tiranë apo takime të organizuara nga aktorë të ndryshëm universitare me qëllim bashkëpunimin shkencor dhe aplikimin e përbashkët në projekte**.**<br><br>AU disponon të dhënat për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca si dhe të dhëna për projektë kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit Master. Pedagogët jank të përfshirë në disa projekte kërkimore-shkencore ku kanë aplikuar individualisht dhe në një program ndërkombëtar ku janë të angazhuar si pjesë e departamentit.<br><br>Konstatohet se AU disponon të dhënat për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca si dhe të dhëna për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit Master. Këto materiale janë të disponueshme në Departamnet si një fond për ata studentë e pedagogë të rinjë që duan të zhvillojnë më tej karrierën e tyre akademike e shkencore.<br><br>Konstatohet se Institucioni nxit studentët të aplikojnë në projekte mobiliteti duke ndarë çdo informacion të ardhur prej universiteteve të huaja ose zyrës Erasmus në Tiranë. Institucioni lejon transferimin e krediteve të fituara në Universitet ku kryejnë studimet në projektet Erasmus dhe Erasmus plus dhe i integron në kohë për vazhdimin e studimeve.<br><br>RVB nuk paraqet Aneks mbi veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, nga personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore.<br><br>**[Aneksi 4.2 Informacion mbi kontaktet e krijuara me Universitete [Shtator 2018-Janar 2019]; [Aneksi 10.9].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.8**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në | Bazuar në RVB, vizitën në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se institucioni ka kapacitetet dhe infrastrukturën për orientimin dhe informimin e studentëve. Zyra e Koordinimit dhe |

| | |
|---|---|
| përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.<br><br>**Kriteri 4.** Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse<br><br>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështesin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.<br><br>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës. | Mbështetjes për Studentët janë dy njësitë kryesore në shërbim të informimit të studentëve, krahas Departamentit dhe Sekretarisë mësimore.<br><br>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e studentëve të cilët përfundojnë ciklin e parë të studimit Bachelor, mbi programet e ciklit të dytë të studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Ekonomike. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në bashkëpunim të ngushtë me departamentin mbështet dhe informon studentët përgjatë kohëzgjatjes së studimeve dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit.<br><br>Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdetari [tutorit] për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët.<br><br>Konstatohet se Institucioni përmes Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit informon vazhdimisht studentët mbi mundësitë e punësimit, organizon aktivitete të ndryshme orientuese dhe këshilluese argëtuese mbështet studentët në aplikimet e tyre, mundëson aplikime për punësim në kompani të ndryshme me të cilat Institucioni bashkëpunon.<br><br>GVJ konstaton se ZKA mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës. Departamenti me mbështetjen e ZKA, duke iu referuar edhe institucioneve/ bizneseve me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit, pranë të cilit do të zhvillojnë praktikën mësimore.<br><br>Gjithashtu u konstatuar se Zyra e Karrierës dhe Alumnit në mënyrë periodike azhornon të dhënat mbi punësimin e studentëve të diplomuar, i përpunon dhe ruan ato dhe i bën të disponueshme për autoritetet drejtuese.<br><br>Departamenti i Shkencave Ekonomike organizon pjesëmarrjen e studentëve në akademik motivojnë dhe mbështetin konferencat shkencore studentore [konferenca e përbashkët me AMF]. Pedagogët ndihmojnë studentët në përgatitjen e artikujve dhe zgjedhjen e temave të studimit. Artikujt janë zakonisht pjesë e punës së Diplomës.<br><br>Përveç orëve në auditor për përgatitjen e Temës së Diplomës, studentët komunikojnë në mënyrë periodike me pedagogët drejtues. Punimi përfundimtar analizave, matjeve studimeve dhe miratohet nga pedagogu udhëheqës [konfirmimi me email] përpara se të dorëzohet përfundimisht në departament.<br><br>**[Aneksi 5.4.a Informacion mbi zhvillimin e aktivitetit Yoga per studentet, Aneksi 5.4.b Informacion mbi krijimin e Klubit Sportiv te Shahut, Aneksi 5.4.c Perfshirje ne Kampionatin Kombetar** |

| | |
|---|---|
| | **Universitar 2019 – 2020 dhe Aneksi 5.4.d Informacion mbi mundësinë e punësimit pranë Noa Holding] [Aneksi 5.2 Rregullore e ZKMS] [Aneksi 5.3 Rregullore e ZKA], [RVB Tabela 5].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vlerëson se institucioni është i pajisur me strukturat që garantojnë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së brendshme duke përfshirë edhe programin Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar". "Albanian University" për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka hartuar politika në nivel institucional, si dhe ka ngritur strukturat përkatëse deri në nivel Njësie Bazë, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të duhur. Strukturat e ngritura dhe procedurat e ndjekura janë në përputhje me "Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me Manualin "Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit".<br><br>Konstatohet se në "Albanian University", Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon që nga viti 2009 - 2010. Që nga ajo kohë, Universiteti për të institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, me Vendim të Senatit Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional**,** pjesë e të cilit është edhe një student. Studentët, gjithashtu, janë të përfshirë si pjesë e grupit të punës në çdo rast kur institucioni realizon akreditimin institucional apo akreditimin e programeve të studimit, si dhe gjatë realizimit të pyetësorëve. Prej shtatorit të vitit 2016, në mbështetje të cilësisë në "Albanian University", funksionon edhe grupi i sigurimit të cilësisë |

| | |
|---|---|
| tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | në nivel njësie bazë, ngritur me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016, anëtarët e të cilëve përditësohen çdo vit. Institucioni i jep një rëndësi të veçantë sigurimit të cilësisë në çdo iniciativë akademike dhe për këtë arsye, politikat e sigurimit të cilësisë nuk paraqiten vetëm në strategjinë institucionale të Institucionit, por në mënyrë të detajuar në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Bazuar në nevojat e Institucionit, si dhe në kuadër të marrjes së vendimeve sa më objektive dhe efikase, NjSBC bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë tij: 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave.<br><br>AU në kuadër të sigurimit të cilësisë i kushton një rëndësi të vecantë rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore, me eksperiencë në fushën përkatëse. Trajnimi i stafit akademik është një element i rëndësishëm i politikave të institucionit për ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të sigurimit të cilësisë. Zakonisht në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë tij, realizohen trajnime me personelin akademik, në disa raste edhe me lektorë të huaj, për çështje të tilla që lidhen me teknologjitë e mësimdhënies, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, etj.. Instrumentat e shumta, si pyetësorët me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirsimin e cilësisë nëse është e nevojshme. Gjithashtu, Institucioni në mënyrë periodike realizon vlerësimin e jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, si dhe merr të gjitha masat për të plotësuar maksimalisht rekomandimet e lëna nga vlerësuesit e jashtëm dhe Bordi i Akreditimit.<br><br>GVJ konstaton se politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit paraqiten në Strategjinë e zhvillimit institucional, si dhe në Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së Institucionit. Konkretisht, në përfundim të vitit akademik grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti plotëson raportin e vetëvlerësimit të programit të studimit në të cilin paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedback-u i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj.. Gjithashtu, në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik Njësia Bazë harton një raport semestral dhe një raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësimin në të ardhmen.<br><br>**[Aneksi 3.5.a Axhenda e trajnimeve te stafit akademik 2018-2019 dhe Aneksit 3.5.b Axhenda e trajnimeve te stafit akademik 2019-2020]; [Aneksi 1.1 Plani strategjik institucional 2017-2022, pika 2 jo fusha 4, fq. 17], [Aneksi 6.5.a VB - E. P dhe Aneksi 6.5.b VB - E.B]; [Aneksi 6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë]; [Aneksi 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti-08** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **09 2016, Aneksi 6.3.b Sigurimi i Cilësisë në Nivel departamenti, v.a 2018-2019 dhe Aneksi 6.3.c Sigurimi i Cilësisë në Nivel Departamenti, v.a 2020-2021]; [Aneksi 6.2 VS - krijimi i KVI - 22 12 2016]** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.<br><br>**Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.<br><br>**Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | Bazuar në RVB, vizitën në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se "Albanian University", përvec strukturave specifike për ruajtjen, përmirësimin dhe monitorimin e cilësisë ka ngritur edhe Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti [Aneksi 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti-08 09 2016, Aneksi 6.3.b Sigurimi i Cilësisë në Nivel departamenti, v.a 2018-2019 dhe Aneksi 6.3.c Sigurimi i Cilësisë në Nivel Departamenti, v.a 2020-2021]. Këto janë grupe ad-hoc, të cilat përbëhen nga programe të studimit të ciklit të staf akademik i brendshëm i Njësisë Bazë, konkretisht 2 apo 3 pedagogë me tituj e me grada, të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve, në bashkëpunim me lektorët e lëndëve, hartimin e raportit të vetëvlerësimit për programin e studimit, si dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit.<br><br>GVJ konstatoi se çdo fillim viti, nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Departamenti në bashkëpunim me Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorlët në azhornimin e syllabuseve, në përputhje me të rejat më të fundit në lëndën përkatëse dhe azhornimet e literaturës aty ku është e nevojshme. Për rishikimin e programeve të studimit, në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat e diktuara nga studimi i tregut të punës, Departamenti ngre grupin e punës ad-hoc dhe ndjek procedurën përkatëse për miratimin e tij, të shprehur në Rregulloren për Mbarëvajtjen e Kurrikulave dhe Progesit Mësimor në "Albanian University" [Aneksi 6.6 Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave, neni 9, fq. 4].<br><br>GVJ konstaton se AU për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përdor metoda të tërthorta dhe të drejtëpërdrejta si:<br><br>Të tërthorta:<br><br>1 Pyetësorë të studentëve [2 herë në vit] [Aneksi R.4.a Raport Vjetor DSHE 2018-2019 dhe Aneksi R.4.b Raport vjetor DSHE 2019-2020], 2 Fokus grupe [në muajin dhjetor], mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, |

infrastrukturës, etj., [Aneksi 6.7.a Njoftim për realizimin e Fokus-Grupeve - Shkurt 2019 dhe Aneksi 6.7.b Njoftim për realizimin e Fokus-Grupeve - Janar 2020], 3 Raporte vetëvlerësimi të pedagogëve [Aneksi 3.2 Formati raport vetevleresimi i stafit akademik, raport semestral],

Të drejtëpërdrejta:

1. Bëhet vlerësimi me notë dhe pikë;
2. Hartohen teste paraprake dhe përfundimtare;
3. Bëhen vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve.

Gjithashtu, GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimeve të realizuara nga NjSBC dokumentohen në formë shkresore dhe i dërgohen të gjitha instancave përkatëse. Kështu, pas realizimit të focus grupeve, informacioni i dërgohet Rektoratit dhe çdo Njësie Bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave nga pyetësorët e studentëve, informacioni dërgohet në departament, i cili i diskuton në mbledhje të posatshme dhe ia komunikon në mënyrë konfidenciale personelit akademik. Për më tepër, të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e studentëve diskutohen edhe në mbledhje të Senatit Akademik. Të gjitha të dhënat e mbledhura në mënyrë periodike gjatë vitit akademik pasqyrohen në raportet vjetore duke filluar nga Njësia Bazë e duke vazhduar deri në instancat më të larta akademike dhe administrative [Senati Akademik dhe Bordi i Administimit] për t'u dërguar pastaj në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit

https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/

GVJ konstaton se Raportet e vlerësimit përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen.

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konkludon se procesi i sigurimit të cilësisë në "Albanian University" është një process zinxhir, i cili përfshin të gjithë aktorët duke filluar që nga Njësia Bazë me grupet |

<table>
<tr>
<td>cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.<br><br>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.<br><br>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.<br><br>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara [alumni], të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</td>
<td colspan="4">e sigurimit të cilësisë, të cilët realizojnë në përfundim të çdo viti akademik raportin e vetëvlertësimit të programit të studimit. Ky raport i përcillet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe Njësisë Bazë përkatëse, e cila këtë informacion e përfshin në raportin vjetor të departamentit. Në këtë mënyrë informacioni përcillet deri në instancat më të larta, si dhe paraqitet në raportin e vlerësimit të brendshëm në rastet kur programi kalon vlerësimin periodik.<br><br>Departamenti i Shkencave Ekonomike, përveç vlerësimeve në rang institucioni angazhohet në vlerësimin e programeve të studimit dhe ofertës akademike me metoda dhe instrumenta specifike të fushës. Në mënyrë të vazhduar, edhe si pjesë studimesh kërkimore - shkencore të stafit akademik. Departamenti i drejtohet studentëve për të marrë feedback për problematika të ndryshme, të cilat prekin drejtëpërsëdrejti programet e studimit të ofruara. Kjo realizohet mes kontakteve të drejtëpërdrejta të studentëve me Departamentin përmes emaileve apo takimeve ad-hoc në departament me drejtuesin për çështje specifike të mësimdhënies apo mësimnxënies.<br><br>Gjithshtu, pjesë e metodave të vlerësimit janë edhe vlerësimet e drejtëpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës, apo edhe kërkesave të personelit akademik, apo studentëve kur vlerësohet si e domosdoshme.<br><br>GVJ konstaton se pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët aktualë janë periodike dy herë në vit pyetësorë dhe një herë në vit fokus grupe. Ndërkohë, AU në vitin akademik 2018 - 2019 ka realizuar për here të pare edhe një pyetësor me personelin akademik, për të marrë përshtypjen e tyre në lidhje me çfarë i ofron Institucioni dhe sa të kënaqur janë ata. Gjithashtu, zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me Alumn-it e “Albanian University”<br><br>[Aneksi 6.7.a Njoftim për realizimin e Fokus-Grupeve -Shkurt 2019 dhe Aneksi 6.7.b Njoftim për realizimin e Fokus-Grupeve - Janar 2020].</td>
</tr>
<tr>
<td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td>
<td>Nuk përmbushet</td>
<td>Përmbushet pjesërisht</td>
<td>Përmbushet kryesisht</td>
<td>Përmbushet plotësisht</td>
</tr>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td>X</td>
</tr>
</table>

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.<br><br>**Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.<br><br>**Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Pas vizitës në institucion, takimeve me Dekanin, përgjegjësen e Departamentit, stafin akademik, studentët si edhe pasi u shqyrtua dokumentacioni i depozituar nga institucioni, GVJ konstatoi se institucioni në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të parametrave të cilësisë bashkëpunon ngushtë edhe me ekspertë të jashtëm, kryesisht nga Institucionet me të cilat Njësia Bazë ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>GVJ konstaton se Në rregulloren e NJSBC janë të parashikuara detyrat e palëve të përfshira në çeshtjet e cilësisë [Aneksi 6.8 Rregullore NJSBC].<br><br>Gjithashtu, në procedurat e vlerësimit të cilësisë marrin pjesë të gjithë aktorët, të cilët kanë një ndikim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e programit të studimit. Njësia Bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional.<br><br>GVJ evidenton nga RVB se institucioni respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare, si dhe respekton Kodin e Etikës të "Albanian University".<br><br>Në kuadër të vlerësimeve periodike të programeve të studimit një vëmendje e veçantë i kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm. Gjithashtu, në fazën e rishikimit të programe të studimit Brenda masës së lejuar deri në 20% [Aneksi 6.9 nuk ekziston në databazen e ngarkuar].<br><br>Institucioni here pas here angazhon edhe ekspertë të jashtëm. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.<br><br>**Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se "Albanian University" në përfundim të çdo viti akademik në perputhje me udhëzimin Nr. 5 dt. 18/02/2018, dërgon pranë MASR raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore të Institucionit, si dhe e bën publike për të gjithë të interesuarit në faqen web https:/albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise.<br><br>Konstatohet gjithashtu se raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore të institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë dhe etikën akademike.<br><br>Raporti i vetëvlerësimit të programit të studimit, si dhe raporti vjetor i departamentit përfshin edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik.<br><br>U evidentua se Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm informon studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në "Menaxhim Bankar" të Universitetit Privat "Albanian University", Tiranë.</u>**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Jetëgjatësia e programit të studimit dhe konsolidimi i tij në kohë.
2. Albanian University dhe specifikisht Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, ka kapacitetet dhe infrastrukturën për orientimin dhe informimin e studentëve.
3. Përqasja mjaft pozitive dhe mbështetëse ndaj studentëve.

**Pika të dobta:**

1. Mungesa e mobiliteteve dhe ndërkombetarizimit të programit
2. Mungesa e bashkëpunimeve me institucione bankare të cilat do të ishin mbështetësit kryesor të programit Master i Shkencave në "Menaxhim Bankar".
3. Numri i ulët i stafit akademik me tituj/grada në departament.
4. Numri i bashkëpunimeve nuk ka benefite konkrete për studentët
5. Mungon orientimi i kurrikulës nga tregu apo eksperiencat e ALUMNI
6. Në rregulloren e regjistrimit mungon përcaktimi i gjuhës së huaj sipas kritereve të përcaktuara nga MASR
7. Mungesa e nje strategjie/plani/procedure per krijimin/promovimin e kerkimit shkencor ne nivel institucional per stafin akademik si dhe per perfshirjen e studenteve ne aktivitetet akademike dhe ne promovimin e puneve te tyre shkencore
8. Mungesa e perpjekjeve te institucionalizuara per bashkepunime ne projekte ose hartime planesh strategjike
9. Mungesa e procedurave për motivimin, promovimin dhe mbështetjen e stafit akademik në mësimdhënie dhe kërkim shkencor si dhe në pjesemarrje projektesh me institucione brenda dhe jashte vendit.
10. Mungesa e pjesëmarrjes në programet e shkëmbimit të studenteve dhe stafit.

**Rekomandime:**

1. Të rritet prania e stafit të brendshëm me grada të larta shkencore, të cilët kalojnë aktivitetet kryesore në Departament.
2. Rekomandohet qe programi i studimit të ofroje një ose disa module në gjuhën angleze në mënyrë që të aksesohet edhe nga studentë të ardhur nga mobilitetet.
3. Të përfshihet një analize e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe përfitimet prej tyre në raportin e Departamentit.

4. Te kryhet një përpjekje më e organizuar në lidhje më promovimin e rezultateve në kërkimin shkencor për stafin dhe për studentët, duke inkurajuar përfshirjen e tyre në aktivitete shkencore ndërkombëtare dhe në iniciativa vetjake në fushën e kërkimit shkencor.
5. Te zhvillohet një politikë e mbrojtjes se pronesise intelektuale në kontekstin e botimit të Revistës Optime me detaje që i përkasin procesit të botimit.
6. Rekomandohet krijimi i nje procesi organizues në konsiderimin e opinioneve dhe propozimeve nga bashkëpuntorë dhe ekspertë të jashtëm si dhe opinionin e Alumni për përmirësimin e programit të studimit.
7. Rekomandohet krijimi i bashkëpunime të vecanta me IAL apo institucione të tjera për hapjen e fushave të kërkimit që kanë lidhje më programin e studimit.
8. Të krijohet një komision i posaçëm për administrimin e provimit final.
9. Te dokumentohet informacioni që lidhet me aktivitetin e personelit akademik mbi veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie për periudha të ndryshme kohore.
10. Te rishikohet i rregullorja mesimore e programit ne lidhje me kriteret e pranimit dhe perputhjen e tyre me ligjin dhe procedurat e ndjekura.
11. Te krijohet nje strategji promovimi per stafin akademik
12. Te intenstifikohen perpjekjet per informimin per programet e mobilitetit per stafin dhe studentet.

**<u>Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Msc in "Banking Management" of the Private University "Albanian University", in Tirana.</u>**

**<u>Strengths and affirmations:</u>**

1. Longevity of the program and its consolidation during time
2. AU and the Faculty of Applied and Economic Sciences has the capasities and the infrustruxture to support and inform the students.
3. Positive and supportive approach towards the students.

**<u>Weaknesses:</u>**

1. Lack of mobility and internationalization of the program.
2. Lack of collaborations with financial institutions, which should be the best supporters of the program.
3. Low number of academic personnel with titles.
4. Collaborations with third parties do not have concrete results and benefits for the students
5. There is a lack of orientation of the program from the market or ALUMNI experience
6. Foreign language, according to the law is not defined in the admissions/registration regulation

7. There is a lack of strategy/plan/procedure to create/promote scientific research in institutional level for the benefit of academics, and the involvement of the students in acadmic activities and in promoting their own scientific work.
8. There is a lack of institutionalized attempts to collaborate in projects or strategic plans.
9. Lack of procedure for the motivation, promotion, support of academic staff in teaching and research and in project participation with other institutions in and out of the country.
10. Lack of presence in exchange programs for the staff and the students.

**Recommendations:**

1. Increase of internal academic staff with titles that are involved in the main activities of the Department.
2. The program to include one or two subjects in English language in order to be accessible from mobility students and staff.
3. To include a cost/benefit analysis of the collaboration agreements in the Department's report.
4. To enhance the promotion of results in scientific research of the professors and students and to encourage their inclusion in national and international scientific activities as well as to support personal initiatives in the field of scientific research.
5. To create a copyright/authorship policy in protection of the intellectual property in the framework of publishing the journal OPTIME, including details of the publishing process.
6. To create and apply an organized process that gathers and considers the opinions and proposals of external experts, collaborative parts, Alumni etc. in the benefit and melioration of the study program.
7. To enhance collaboration with other universities or companies to open research topics linked with the study program.
8. To create a special Commission for administering the final exam.
9. To document the information of the academic staff regarding scientific research and teaching activities in different times.
10. To review the program regulation regarding the admission criteria and align them with the law requirements.
11. To create a promotion strategy for the academic staff.
12. To intensify the attempts on informing about the mobility programs for the staff and the students.

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |